



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 959 Prot.

Ersekë, më 07.02.2026

**RAPORT PËRFUNDIMTAR**  
**AUDITIM I KOMBINUAR**  
**NË DREJTORINË E TË ARDHURAVE DHE TATIM-TAKSAVE**

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
II.	HYRJE.....	5
III.	METODA E AUDITIMIT .....	7
IV.	GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM	8
V.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA MË PARË .....	100
	ANEKSI Nr.1 .....	101
	ANEKSI Nr.2 .....	103

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Nga struktura organizative e Bashkisë Kolonjë e miratuar për vitin 2024 dhe vitin 2025, rezulton se pranë kësaj Bashkie ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave, e cila për nga struktura organizative për vitin 2024 ka funksionuar si sektor në varësi të Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave, ndërsa gjatë vitit 2025 ka funksionuar si drejtori më vete dhe ka qënë e ndarë në 2 sektorë me një numër prej 6 punonjësish.
2. Në bazë dhe për zbatim të nenit 5, nenit 6 pika “b” ii), v) dhe vi), si dhe pikës 2 të Nenit 9 të Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (*i ndryshuar*), “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, Planit Vjetor të miratuar nga Titullari i Institucionit me Vendimin Nr. 36, datë 16.10.2024 për vitin 2025 si dhe Urdhërit të Shërbimit Nr. 6603 Prot., datë 18.11.2025 të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm, Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Kolonjë, ushtroi auditimin në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave.
3. Objekti i Auditimit: Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave me aktet ligjore në fuqi dhe vlerësimi nëse përmbushja e objektivave të veprimtarisë në këtë drejtori po realizohet nëpërmjet proceseve efektive dhe përdorimit të fondeve me ekonomi, efektivitet dhe efijencë.
4. Qëllimi i Auditimit: Të ndihmojë Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe menaxhimit të riskut.
5. Periudha e Auditimit: 01.01.2024-31.10.2025.
6. Përmbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve kryesore:

Gjatë ushtrimit të këtij auditimi, Njësia e Auditit të Brendshëm ka konstatuar një numër të konsiderueshëm parregullsish. Aspektet kryesore të këtyre parregullsive janë si më poshtë vijon:

- Mospërputhje midis strukturës organizative të miratuar për Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë
- Mungesë e ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësiive për funksionet operative Inspektor Terreni / Faturist Tregu
- Mungesë e përditësimit të bazës ligjore të Drejtorisë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.
- Mangësi në formalizimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm, mungesë rregulloresh dhe manualesh pune.
- Mungesë e dokumentacionit të plotë dhe të qëndrueshëm për planifikimin dhe raportimin e veprimtarisë.
- Përdorim i sistemeve manuale për regjistrimin dhe monitorimin e të ardhurave dhe debitorëve.

- Dobësi në sistemin e informimit, komunikimit dhe raportimit të performancës.
- Mangësi në monitorimin e efektivitetit të masave dhe ndjekjen e veprimeve korigjuese.

**7. A. Sistemi për tarifatat e biznesit dhe taksat e biznesit.**

- Mungesë e arkëtimit të detyrimeve nga subjektet me kontrata prokurimi (Shkalla e vjeljes 0%).
- Mungesa e masave shtrënguese për debitorët me vonesa mbi 12-mujore.
- Mospërmbushje e objektivave të arkëtimit gjatë pjesës së dytë të vitit.
- Mosrakordim midis statusit aktiv të subjekteve në sistem dhe gjendjes reale në terren.
- Mosarkëtimi i plotë i detyrimeve financiare në sektorin “Bar-Restorant”.

**8. B. Sistemi për tarifatat e familjeve dhe taksat e familjeve.**

- Mungesë efikasiteti në vjeljen e detyrimeve dhe administrim i dobët i debisë historike
- Pasaktësi në administrimin e bazës së të dhënave dhe mungesë standardizimi në raportim.
- Disproporcion i arkëtimit sipas zonave (Blloqeve) dhe mbulim i pjesshëm i Taksës së Pasurisë.

**9. C. Sistemi për menaxhimin e riskut.**

- Mangësi në formalizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut

**10. D. Sistemi për mbajtjen e listave**

- Mungesa e një sistemi të unifikuar dhe të automatizuar për menaxhimin e listave, evidencave të të ardhurave, debitorëve dhe faturimeve

**11. E. Sistemi për menaxhimin e dhënies së lejeve të transportit.**

- Mangësi në dokumentacionin shoqërues për dhënien dhe rinovimin e lejeve të transportit.

**12. F. Sistemi për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.**

- Mungesë efikasiteti dhe parregullsi në vjeljen e detyrimeve të prapambetura (Debisë Progressive).
- Operimi i subjekteve pa kontratë të rregullt.
- Përqendrimi i lartë i riskut te debitorët e mëdhenj.
- Mosfunksionimi efektiv i vjeljes së taksave në Njësitë Administrative.
- Pasaktësi në mbajtjen e regjistrave.

**13. G. Sistemi i Kadastrës Fiskale**

- Mungesa e sistemit të kadastrës fiskale dhe e bashkëpunimit ndërinstitucional në administrimin e të ardhurave

### Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm

14. *Nga të dhënat vihet re edhe pse struktura është zgjeruar në nivel Drejtorie, mungesa e përditësimit të Rregullores së Brendshme dhe Manualeve të Punës ka krijuar një paqartësi hierarkike. Mungesa e ndarjes së detyrave midis inspektorëve të terrenit dhe faturistëve paraqet risk të lartë për gabime njerëzore dhe shmangie nga përgjegjësia. Sistemi i kontrollit në këtë njësi rezulton jo-efektiv. Nuk ka manuale pune dhe proceset janë manuale jo të digjitalizuara. Mungesa e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut të brendshëm nga vetë njësi, pasqyrohet te realizimet vjetore të vjeljes së detyrimeve.*
15. *Sa i takon performancës fiskale, shkalla e vjeljes 0% për subjektet që kanë kontrata prokurimi me vetë Bashkinë paraqitet problematike, pasi institucioni i paguan këto subjekte për shërbime, por nuk u mbledh detyrimet tatimore që ata i kanë borxh. Po ashtu, mungesa e masave shtrënguese për debitorët mbi 12-mujorë tregon një tolerancë të pajustificuar që rëndon buxhetin. Mosarkëtimi uniform i detyrimeve sipas zonave, tregon se ose ka pasaktësi në terren ose neglizhencë në derdhjen e detyrimeve.*
16. *Aktivitetet e kontrollit janë kryesisht manuale, çka rrit shkallën e gabimeve njerëzore dhe vështirëson monitorimin. Mosrakordimi i statusit të bizneseve midis sistemit dhe terrenit vërteton se kontrollet periodike janë formale dhe jo substanciale, duke çuar në një administrim jo-efikas të bazës së taksapaguesve. Procesi i monitorimit është i pamjaftueshëm, siç dëshmohet nga mbledhja e detyrimeve në shkallën 0% për kategori të caktuara dhe rritja e debisë progresive pa asnjë masë shtrënguese. Gjithashtu, parregullsitë në lejet e transportit (mungesa e dokumentacionit) krijojnë mundësi për problematika ligjore dhe humbje të të ardhurave nga tarifatat e licencimit.*
17. *Mjedisi i kontrollit paraqitet jo plotësisht efektiv dhe me mangësi formale. Sistemi i menaxhimit të riskut joplotësisht funksional. Njësi nuk ka arritur të identifikojë dhe të vlerësojë paraprakisht risqet që lidhen me vjeljen e të ardhurave, siç është përqendrimi i debisë te subjektet e mëdha ose dështimi në vjeljen e detyrimeve nga subjektet me kontrata prokurimi. Operimi pa një Kadastër Fiskale dhe përdorimi i listave të paunifikuara tregon se kontrollet kyçe mbi saktësinë e të dhënave janë të dobëta. Sistemi i informimit brenda Drejtorisë së të Ardhurave vuan nga mungesa e standardizimit. Raportimi i performancës nuk bazohet në të dhëna të sakta dhe të automatizuara, gjë që pengon marrjen e vendimeve të duhura nga ana e titullarit. Mungesa e monitorimit të efektivitetit të masave dhe mosndjekja e veprimeve korrigjuese bëjnë që parregullsitë të përsëriten nga viti në vit, duke ulur cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në tërësi në këtë njësi.*

## II. HYRJE

18. Në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave u realizua auditim i kombinuar që përfshiu sistemin për tarifatat e biznesit, sistemin për taksat e biznesit, sistemin për tarifatat e familjeve, sistemin për taksat e familjeve, sistemin për menaxhimin e riskut, sistemin për mbajtjen e listave, sistemin për menaxhimin e dhënies së lejeve të transportit, sistemin për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe sistemin e Kadastrës Fiskale

### Auditimi u krye bazuar në dispozitat ligjore të mëposhtme:

- Ligjit Nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” (i ndryshuar);
- Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, miratuar me Urdhërin Nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave;
- Urdhëri i Shërbimit Nr.6603 Prot., datë 18.11.2025 të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm;
- Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ndryshuar me Ligjin nr.9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr.9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr.10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013;ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt.28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015.;Ligji nr,106/2017 “ Per disa shtesa dhe ndryshime “
- Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”Udhëzimi I ministrit të punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit nr.11 , date 18.12.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne udhëzime nr.156 datë 24.07.2007,”Për kriteret dhe procedurat e leshimit te te liçensave ,autorizim dhe çertefika per ushtrimin e veprimtaris në transportin rrugor”.
- Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”;
- Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
- Ligji Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifavete perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje”.
- Vendimin I Këshillit të Ministrave Nr 319 date 31.05.2020 “Për menaxhimin e mbetjeve”.
- Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;

-Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.132,datë 07.03.2018 “ Për metodologjinë e vlerës së taksueshme të pasurisë së palujtshme “ Ndërtesa”  
-Ligji nr 57/2020 date 30.04.2020 “Për pyjet”.

19. Auditimi u krye në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të miratuar nga Titullari i Institucionit me me Vendimin Nr. 36, datë 16.10.2024 për vitin 2025 si dhe Programit të Angazhim Auditimit Nr. 6740 Prot., datë 26.11.2025.
20. Për fillimin e misionit, grupi i auditimit kërkoi të zhvillohej takimin prezantues në ambientet e Bashkisë Kolonjë takim i cili nuk u mbajt me subjektin, për shkaqe të pajustificuara.
21. Misioni i auditimit u krye nga grupi i auditimit i përbërë nga:  
  
Znj. Laura Skënderas - audituese, njëkohësisht përgjegjëse e grupit;  
Z. Arnold Fetallari - auditues.
22. Afati i auditimit: Nga data 02.12.2025 deri më datën 06. 02.2026 me kërkesë për shtyrje afati të miratuar nga Titullari me Nr. 7400 Prot., datë 29.12.2025.
23. Titullari i Institucionit, u vu në djeni mbi ecurinë e angazhimit, problematikat e hasura, gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit.

### III. METODA E AUDITIMIT

24. Në misionin e auditimit janë përdorur metoda dhe teknika si:

*1. Rishikimi i dokumentacionit* përmes verifikimit nëse Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave i zbaton ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, shqyrtimi i regjistrave dhe dosjeve duke kontrolluar database, faturimet, akt-detyrimet, vërtetimet e shlyerjes së detyrimeve, licencat, formularët, planet e punës etj.

*2. Intervistat me punonjësit* për të marrë informacion mbi proceset dhe praktikat e ndjekura.

*3. Analiza e të dhënave* për të kontrolluar performancën e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave në periudha të ndryshme për të identifikuar devijime të mundshme.

*4. Testimi i mostrave (Sampling)* duke zgjedhur dokumenta, urdhëra apo vendime dhe akte administrative të tjera për të vlerësuar përputhshmërinë ligjore.

U plotësuan pyetësorët për mjedisin e kontrollit të brendshëm, funksionimin organizativ të Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave etj.,

Grupi i auditimit gjykoi se ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave.

#### IV. GJETJET, KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM

25. Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave ka kaluar një transformim organizativ gjatë viteve 2024–2025. Gjatë vitit 2024 funksiononte si sektor në varësi të Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave, ndërsa gjatë vitit 2025 është shndërruar në një drejtori të pavarur, e ndarë në dy sektorë: sektorin e vlerësimit dhe regjistrimit tatimor dhe sektorin e inspektimit dhe mbledhjes së të ardhurave. Struktura përbëhet nga 6 punonjës faktikë nga 7 të miratuar, duke përfshirë një drejtues, tre specialistë tatim-taksash dhe tre inspektorë terreni, ku një pozicion i inspektorëve është vakant.
26. Nga analiza e strukturës dhe dokumentacionit, rezulton se pozicionet janë të ndara qartë, por ekzistojnë mospërputhje midis strukturës së miratuar dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë, veçanërisht për pozicionin e Faturistit të Tregut, ku Inspektori i Terrenit mund të ushtrojë edhe këtë funksion, pa një ndarje të qartë të detyrave. Gjithashtu, baza ligjore e Drejtorisë, e përcaktuar në nenin 70 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë, nuk është përditësuar sipas ndryshimeve ligjore.
27. Nga pikëpamja e mjedisit të kontrollit, Drejtoria ka disa mangësi të dukshme: nuk ekziston një Rregullore e Brendshme të Drejtorisë, nuk është miratuar Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Strukturës Vendore të Apelitit Tatimor, dhe nuk ka manual të proceseve të punës apo “hartë auditimi” të miratuar. Megjithatë, Drejtoria ka hartuar dhe miratuar Planet Vjetore dhe Planet Mujore të Punës dhe ka mbajtur evidencat për realizimin e të ardhurave, edhe pse mungojnë disa dokumente për muajin Gusht dhe Maj 2025. Lista e prezencës së punonjësve është mbajtur rregullisht, dhe çështjet e kërkuara ligjore janë adresuar përmes miratimeve në Këshillin Bashkiak. Kjo tregon një nivel të moderuar të disiplinës së brendshme, por mungesa e formalizimit të dokumenteve themelore kufizon kontrollin dhe transparencën.
28. Aktivitetet operative për arkëtimin e të ardhurave dhe menaxhimin e debitorëve kryhen rregullisht, por sistemet e regjistrimit dhe monitorimit janë kryesisht manuale. Raportimi periodik nuk është gjithmonë i përmbushur dhe raportet e monitorimit të performancës mungojnë, veprimet korrigjuese janë adresuar sipas kërkesave ligjore, por nuk ka procedura standarde të dokumentuara për trajtimin e boshllëqeve ose për lidhjen e tyre me masat e menaxhimit të riskut.
29. Sa i përket informimit dhe komunikimit, Drejtoria ka raportuar performancën në mënyrë të pjesshme dhe informacioni për të ardhurat, debitorët dhe faturimet arrin tek personat përgjegjës në kohë në pjesën më të madhe të rasteve. Megjithatë, mungojnë dokumentet e dorëzuara për raportet e monitorimit dhe përditësimin e masave, duke kufizuar transparencën dhe mundësinë për marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna të sakta.

30. Në aspektin e monitorimit, nuk ka raporte të detajuara për efektivitetin e masave korigjuese, nuk kryhet përditësimi i planeve sipas ndryshimeve të riskut, dhe përdorimi i informacionit për vendimmarrje operative dhe strategjike është i kufizuar. Mungesa e një sistemi të dokumentuar për ndjekjen e masave dhe raportimin e tyre rrit mundësinë për gabime ose moskoordinim.
31. Në përmbledhje, Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave ka një bazë të funksionimit të rregullt në aspektin e proceseve operative dhe mbajtjes së evidencave bazike, por paraqet dobësi të konsiderueshme në formalizimin e mjedisit të kontrollit, dokumentacionin ligjor dhe procedural, menaxhimin e riskut, monitorimin e aktiviteteve dhe komunikimin e brendshëm. Mangësitë kryesore lidhen me: mosformalizimin e rregulloreve dhe manualeve të punës, përdorimin e sistemeve manuale, mungesën e raportimeve periodike dhe të integruara, dhe paqartësinë e ndarjes së përgjegjësive dhe rolit të punonjësve. Përmirësimi i sistemit kërkon formalizimin e dokumenteve, përditësimin e strukturës ligjore dhe procedurave, krijimin e sistemeve elektronike për regjistrim dhe monitorim, raportim periodik të riskut dhe performancës, dhe integrimin e menaxhimit të riskut dhe masave korigjuese në vendimmarrje operative dhe strategjike.
32. Procesi i kontrollit dhe inspektimit në terren ka përbërë një shtyllë qendrore të punës së Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tatim-Taksave, i cili realizohet përmes një monitorimi periodik mujor nga inspektorët e terrenit. Ky proces ka synuar verifikimin në kohë reale të ligjshmërisë së bizneseve, duke u fokusuar specifiku në pajisjen e tyre me NIPT dhe shlyerjen e rregullt të detyrimeve tatimore. Gjatë auditimit u evidentua një ndjekje strikte e subjekteve informale, ku për çdo shkëlqje apo mospërbushje të detyrimeve janë mbajtur procesverbale tip, të cilat janë pasur nga aplikimi i kamatëvonesave prej 0.06% sipas paketës fiskale në fuqi. Nga të dhënat e raportuara, vërehet një identifikim i hollësishëm i rasteve specifike, ku përfshihen biznese si lavazhe, njësi prodhimi duralumini apo bar-kafe, duke i kategorizuar ato sipas statusit të tyre aktual: subjekte që janë legalizuar rishtazi duke hapur NIPT-in pas presionit të kontrollit si dhe subjekte që janë larguar ose kanë mbyllur aktivitetin, duke siguruar kështu një pasqyrim të saktë të bazës tatimore dhe minimizimin e evazionit fiskal.
33. **Titulli i Gjetjes:** Mospërputhje midis strukturës organizative të miratuar për Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë.

<b>Nr. i Gjetjes 1</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>

<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Gjatë auditimit u konstatua se struktura organizative e miratuar për Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave nuk është plotësisht në përputhje me parashikimet e Rregullores së Brendshme të Bashkisë Kolonjë. Disa pozicione dhe funksione të reflektuara në strukturë nuk përputhen me ato të përcaktuara në rregullore.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mospërputhja krijon paqartësi organizative, cenon mjedisin e kontrollit dhe rrit riskun për mbivendosje funksionesh ose mosushtrim efektiv të përgjegjësiave.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë përditësimi dhe harmonizimi të dokumentacionit organizativ pas ndryshimeve strukturore.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Mjedisi i kontrollit është i dobësuar për shkak të mungesës së përputhjes ndërmjet strukturës organizative dhe dokumentave rregullatore.
<b>Rekomandimi</b>	Të përditësohet Rregullorja e Brendshme e Bashkisë dhe të harmonizohet me strukturën organizative aktuale të Drejtorisë.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Brenda 6 mujorit të parë 2026.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

34. **Titulli i Gjetjes:** Mungesë e ndarjes së qartë të detyrave dhe përgjegjësiave për funksionet operative Inspektor Terreni / Faturist Tregu.

<b>Nr. i Gjetjes 2</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave

<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nga dokumentacioni rezulton se Inspektori i Terrenit parashikohet edhe si mundësi për ushtrimin e funksionit të Faturistit të Tregut, pa një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet këtyre funksioneve</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e ndarjes së qartë rrit riskun për gabime, konflikt interesi dhe dobëson kontrollin mbi proceset e arkëtimit.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mospërditësim i rregullores.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Dobësitë në ndarjen e detyrave cenojnë aktivitetet e kontrollit dhe integritetin e proceseve operative.
<b>Rekomandimi</b>	Të përcaktohen qartë dhe të dokumentohen detyrat për secilin funksion dhe të shmanget mbivendosja e roleve.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Menjëherë.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

35. Titulli i Gjetjes: Mungesë e përditësimit të bazës ligjore të Drejtorisë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.

<b>Nr. i Gjetjes 3</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave

<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Neni 70 i Rregullores së Brendshme të Bashkisë Kolonjë, që përcakton bazën ligjore të Drejtorisë, nuk është përditësuar sipas ndryshimeve ligjore të fundit në fushën fiskale.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Risk për zbatim jo të plotë ose jo të saktë të legjislacionit në fuqi.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë mekanizmash për rishikim periodik të bazës ligjore.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Kuadri normativ i papërditësuar dobëson mjedisin e kontrollit dhe sigurinë ligjore.
<b>Rekomandimi</b>	Të përditësohet baza ligjore e Drejtorisë në përputhje me legjislacionin aktual.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Menjëherë.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

36. **Titulli i Gjetjes:** Mangësi në formalizimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm, mungesë rregulloresh dhe manualesh pune.

<b>Nr. i Gjetjes 4</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave

Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
Përmbledhja e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> </ul>
Përshkrimi i gjetjes	<p><b>Situata:</b> Drejtoria nuk disponon Rregullore të Brendshme të saj, nuk ka manual të proceseve të punës dhe Rregullorja për Strukturën Vendore të Apelimit Tatimor nuk është miratuar.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesë standardizimi të proceseve dhe dobësim i kontrollit të brendshëm.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë prioriteti në hartimin dhe miratimin e dokumentacionit bazë.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Mjedisi i kontrollit nuk është i formalizuar dhe nuk mbështet funksionimin efektiv të Drejtorisë.
Rekomandimi	Të hartohen dhe miratohen rregulloret dhe manualët e nevojshme të punës.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë.
Statusi i rekomandimit	

37. Titulli i Gjetjes: Mungesë e dokumentacionit të plotë dhe të qëndrueshëm për planifikimin dhe raportimin e veprimtarisë.

Nr. i Gjetjes 5	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave

<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Megjithëse planet vjetore dhe mujore hartohen rregullisht, mungojnë disa dokumente konkrete për periudha të caktuara dhe raportimi nuk është i plotë.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Cenim i transparencës dhe i monitorimit të performancës.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë kontrolli mbi plotësinë e dokumentacionit.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Sistemi i raportimit është i pjesshëm dhe kërkon përmirësim.
<b>Rekomandimi</b>	Të sigurohet dokumentim i plotë dhe raportim i rregullt i veprimtarisë.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

38. **Titulli i Gjetjes:** Përdorim i sistemeve manuale për regjistrimin dhe monitorimin e të ardhurave dhe debitorëve.

<b>Nr. i Gjetjes 6</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>

<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” <i>(i ndryshuar)</i>;</li> <li>• Manuali i MFK</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Proceset e regjistrimit dhe monitorimit të të ardhurave dhe debitorëve kryhen kryesisht në mënyrë manuale.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” <i>(i ndryshuar)</i>; Manuali i MFK</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Rritje e riskut për gabime dhe mospërputhje të të dhënave.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë investimi në sisteme elektronike.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Aktivitetet e kontrollit nuk mbështeten nga sisteme moderne dhe të besueshme.
<b>Rekomandimi</b>	Të ndërmerren masa për përdorimin e sistemeve elektronike të regjistrimit dhe monitorimit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

39. **Titulli i Gjetjes:** Dobësi në sistemin e informimit, komunikimit dhe raportimit të performancës.

<b>Nr. i Gjetjes 7</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” <i>(i ndryshuar)</i>;</li> </ul>

<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Raportimi i performancës kryhet në mënyrë të pjesshme dhe mungojnë raporte të strukturuar monitorimi.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Vendimmarrje jo plotësisht e bazuar në informacion të dokumentuar.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë procedurash të formalizuara raportimi.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Sistemi i komunikimit të brendshëm nuk është plotësisht efektiv.
<b>Rekomandimi</b>	Të formalizohet raportimi periodik i performancës dhe monitorimit.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Menjëherë dhe në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

40. **Titulli i Gjetjes:** Mangësi në monitorimin e efektivitetit të masave dhe ndjekjen e veprimeve korrigjuese.

<b>Nr. i Gjetjes 8</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> <li>• Manuali i MFK.</li> </ul>

<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nuk rezultojnë raporte të dokumentuara për monitorimin e efektivitetit të masave dhe ndjekjen e veprimeve korrigjuese.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); Manuali i MFK</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Dobësim i përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë sistemi të dokumentuar monitorimi.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I lartë.
<b>Konkluzioni</b>	Monitorimi i kontrollit të brendshëm nuk është efektiv dhe i dokumentuar.
<b>Rekomandimi</b>	Të krijohet një sistem i rregullt monitorimi dhe raportimi të masave korrigjuese.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Menjëherë.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

**Opinion i përgjithshëm:**

41. Bazuar në evidencat e mbledhura dhe analizën e kryer gjatë auditimit, konstatohet se sistemi i kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave është i ngritur në mënyrë bazike dhe funksionon pjesërisht, por nuk është i formalizuar dhe i konsoliduar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe parimet e modelit COSO. Drejtoria ka arritur të sigurojë vazhdimësinë e proceseve operative për arkëtimin e të ardhurave, menaxhimin e debitorëve dhe mbajtjen e evidencave bazike, që tregon një nivel minimal funksionaliteti të kontrollit të brendshëm. Megjithatë, ky funksionim mbështetet kryesisht në praktika operative dhe përvojën individuale të stafit, më shumë sesa në procedura të dokumentuara dhe sisteme të standardizuara.
42. Mjedisi i kontrollit paraqet dobësi të rëndësishme, të lidhura kryesisht me mungesën e dokumenteve themelore rregullatore dhe procedurale, mospërputhjen ndërmjet strukturës organizative dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë, si dhe paqartësinë në ndarjen e roleve dhe përgjegjësi për disa funksione operative. Këto mangësi çënojnë qartësinë organizative, dobësojnë disiplinën e brendshme dhe rrisin riskun për mbivendosje funksionesh ose ushtrim jo

të njëtrajtshëm të detyrave. Ndryshimi organizativ i Drejtorisë gjatë viteve 2024–2025, megjithëse pozitiv në drejtim të forcimit institucional, nuk është shoqëruar me përditësimin dhe harmonizimin e dokumentacionit përkatës, duke krijuar boshllëqe në kuadrin rregullator.

43. Në aspektin e aktiviteteve të kontrollit, Drejtoria ka siguruar funksionimin e proceseve kryesore të arkëtimit dhe menaxhimit të debitorëve, por këto procese kryhen kryesisht në mënyrë manuale dhe nuk mbështeten nga sisteme elektronike të integruara. Përdorimi i sistemeve manuale, mungesa e raportimit periodik të strukturuar dhe dokumentimi i pjesshëm i veprimeve korigjuese kufizojnë gjurmën e auditimit dhe rrisin riskun për gabime ose mospërputhje në të dhëna. Aktivitetet e kontrollit nuk janë të lidhura në mënyrë të qartë me analiza sistematike të riskut dhe nuk mbështeten nga procedura standarde të miratuara.
44. Sa i përket informimit dhe komunikimit, evidencat tregojnë se informacioni bazë mbi të ardhurat, debitorët dhe faturimet arrin tek personat përgjegjës në kohë në pjesën më të madhe të rasteve, por raportimi i performancës dhe i gjendjes së kontrolleve është i pjesshëm dhe jo i qëndrueshëm. Mungesa e raporteve të dokumentuara të monitorimit dhe e një sistemi të strukturuar raportimi kufizon transparencën dhe aftësinë e menaxhmentit për të marrë vendime të bazuara në informacion të plotë dhe të besueshëm.
45. Komponenti i monitorimit përbën një nga dobësitë kryesore të sistemit të kontrollit të brendshëm. Nuk rezulton të ketë monitorim të rregullt dhe të dokumentuar të efektivitetit të masave korigjuese dhe të procedurave të vendosura, nuk ka përditësim sistematik të masave sipas ndryshimeve operative dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit është i kufizuar. Kjo situatë rrit mundësinë që dobësitë të përsëriten dhe të mos adresohen në kohë.
46. Në përfundim, sistemi i kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave vlerësohet i pjesshëm dhe me efektivitet të kufizuar, duke mos ofruar siguri të arsyeshme për arritjen e objektivave të administrimit efektiv të të ardhurave, përputhshmërisë ligjore dhe përdorimit efikas të burimeve. Përmirësimi i sistemit kërkon një qasje të integruar, e cila përfshin formalizimin e mjedisit të kontrollit, përditësimin e kuadrit ligjor dhe organizativ, standardizimin e procedurave operative, forcimin e raportimit dhe monitorimit si dhe konsolidimin e përdorimit të informacionit për vendimmarrje operative dhe strategjike. Vetëm në këtë mënyrë Drejtoria mund të sigurojë një sistem kontrolli të brendshëm funksional, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

#### 4.1 SISTEMI PËR TARIFAT DHE TAKSAT E BIZNESIT

47. Viti 2024 shfaqet si viti ku janë gjeneruar detyrime të reja për shumicën e subjekteve. Ky vit mbart peshën kryesore të debisë aktuale. Për shumë subjekte janë aplikuar kamatëvonesa specifike për këtë vit, disa subjekte kanë kamata që variojnë nga 168 lekë deri në mbi 2,500 lekë. Subjektet me Debinë më të lartë për vitin 2024 janë si më poshtë vijon:
1. D. M: 32,560 lekë (+ 1,365 kamatë)
  2. L. J: 31,332 lekë (+ 2,976 kamatë)
  3. A. C: 26,760 lekë (+ 2,560 kamatë)
48. Për vitin 2025 janë shkryer detyrimet e mbartura nga viti 2024 nga subjektet si më poshtë vijon.
1. M. N: Ka paguar 19,898 lekë (06.01.2025) - likuidim i plotë.
  2. E. K: Ka paguar 19,670 lekë (10.01.2025).
  3. M. Z: Ka paguar 18,980 lekë (07.02.2025).
  4. E. M : Ka paguar 12,080 lekë (19.03.2025).

Subjekti	Detyrimi 2024	Kamata	Pagesa 2025	Statusi / Data e Pagesës
E.K.	18,120	1,728	19,670	Likuiduar (10.01.2025)
A. Dh	5,560	231	5,610	Likuiduar (17.01.2025)
A. R	7,560	315	7,875	Likuiduar (02.05.2025)
A. M	8,060	336	0	Debitor
B. Z	24,321	2,304	0	Debitor

Tabelë Përmbledhëse Nr.1 Debitorët 2024-2025

49. Një pjesë e mirë e bizneseve kanë shlyer detyrimet e 2024-ës brenda tremujorit të parë të vitit 2025 (Janar-Mars). Subjektet si D. M dhe A. C paraqiten me shifra të larta debie për vitin 2024 pa asnjë pagesë të reflektuar në kolonën e vitit 2025 deri në periudhën e audituar. Kamata për vitin 2024 është llogaritur mesatarisht rreth 8-10% të vlerës së detyrimit bazë për subjektet që nuk kanë paguar detyrimin në kohë. Këto subjekte mbartin detyrimin bazë plus kamatëvonesat e llogaritura:

Emër Mbiemër	Aktiviteti	Detyrim 2024	Kamata	Totali Borxhit
D. M	Kabllor	32,560	1,365	33,925
L. J	Marangoz	31,332	2,976	34,308
A. C	Mekanik	26,760	2,560	29,320
B. Z	Bar Bufë	24,321	2,304	26,625
E. B	Ferme Miks	18,120	1,674	19,794
A. R	Artikuj Industrial	15,120	1,530	16,650
B. L	Prodhime	15,120	1,395	16,515
B.G	Bilardo	8,120	976	9,096
A.M	T. Udhetare 8+1	8,060	336	8,396
F. P	Prodh. Bujqesore	3,100	-	3,100

Tabela Nr.2 Lista e Debitorëve pa pagesa në 2025

50. Nga analiza e të dhënave për këtë periudhë rezulton se, për këta 10 tregtarë, sikurse tregohet në tabelë, borxhi total që duhet arkëtuar është rreth **197,729 lekë**. Subjekti **L. J** ka detyrimin më të lartë total (përfshirë kamatën). Vërehet se kamatëvonesat për vitin 2024 penalizojnë ndjeshëm subjektet me detyrime të mbartura gjatë gjithë vitit. Subjektet që ishin debitorë në 2024 por i kanë shlyer detyrimet në fillim të 2025, janë si më poshtë:

1. M. N: 19,898 lekë (Likuiduar 06.01.2025)
2. E. K: 19,670 lekë (Likuiduar 10.01.2025)
3. M. Z: 18,980 lekë (Likuiduar 07.02.2025)
4. A.R: 7,875 lekë (Likuiduar 02.05.2025)

51. Shuma totale që duhet të mblidhet nga këto subjekte është: **197,729 lekë**, ku detyrimi bazë për 2024 është 184,003 lekë, kamata e llogaritur është 13,726 lekë dhe numri i subjekteve debitorë është 10.

Renditja	Emër Mbiemër	Vlera Totale për Arkëtim	Statusi
1	<b>L. J</b>	<b>34,308 lekë</b>	I pashlyer
2	<b>D. M</b>	<b>33,925 lekë</b>	I pashlyer
3	<b>A. C</b>	<b>29,320 lekë</b>	I pashlyer
4	<b>B. Z</b>	<b>26,625 lekë</b>	I pashlyer
5	<b>E.B</b>	<b>19,794 lekë</b>	I pashlyer
6	<b>A. R</b>	<b>16,650 lekë</b>	I pashlyer
7	<b>B.L</b>	<b>16,515 lekë</b>	I pashlyer
8	<b>B. G</b>	<b>9,096 lekë</b>	I pashlyer
9	<b>A. M</b>	<b>8,396 lekë</b>	I pashlyer
10	<b>F. P</b>	<b>3,100 lekë</b>	I pashlyer

*Tabela Nr.3 Detajimi sipas Vlerës (Nga borxhi më i lartë tek më i ulëti)*

52. Për subjektin **F. P** nuk ka një kamatë të specifikuar në tabelë, ndaj është llogaritur vetëm vlera bazë. Katër subjektet e para (J., M., C., Z.) përbëjnë mbi 60% të borxhit total të mbetur. Fokusimi tek këto subjekte do të sillte arkëtimin më të shpejtë të volumit kryesor të parave.

53. Viti 2024 ka pasur një volum të lartë faturimi, ku pjesa më e madhe e subjekteve kanë shlyer detyrimet brenda vitit kalendarik. Nga lista e subjekteve, tarifat kryesore përfshijnë: Pastrimin, Ndriçimin, Gjelbërimin, Taksa e Tabelës etj. Shumica e bizneseve (si *Raifaisseen Bank, Donika Xhelili, Erseka Solar Park*) i kanë shlyer detyrimet e tyre brenda muajve të parë të vitit 2024 (Shkurt - Qershor). Një pjesë e subjekteve kanë mbartur detyrime që janë klasifikuar si "Debia 2024" për t'u ndjekur në vitin pasardhës.

54. Të dhënat tregojnë se në fillim të vitit 2025 ka pasur një lëvizje të konsiderueshme për likuidimin e mbetjeve të vitit 2024. Subjekte si Arion OIL Erseke (Z. B.) kanë kryer pagesën e plotë prej 57,799 lekë më datë 16.01.2025. "6 Korriku" ka shlyer shumën prej 88,760 lekë

(përfshirë kamatë-vonesën) në Gusht 2025. Për subjektet që nuk paguan brenda vitit 2024, është aplikuar kamatë-vonesë që varion nga 10% deri në 12% të detyrimit bazë.

Subjekti	Detyrimi 2024	Kamata	Total për Pagesë	Statusi / Data e Pagesës
Alned 91	70,540	7,614	78,154	E pashlyer (në listë debie)
Arion OIL	57,799	0	57,799	Paguar (16.01.2025)
6 Korriku	80,120	8,640	88,760	Paguar (15.08.2025)
Duro Shpk	123,350	13,320	136,670	E pashlyer
Raifaizen Bank	281,990	0	281,990	Paguar (23.01.2024)

Tabela nr. 4 Pasqyra Krahasimore

55. Ka një trend pozitiv të vjeljes së debisë në muajin e parë të vitit 2025 (Janar), gjë që tregon reflektim të subjekteve pas mbylljes së vitit fiskal. Kamatë-vonesat e llogaritura për vitin 2025 janë një faktor penalizues që po nxit subjektet si "6 Korriku" të likuidojnë detyrimet e prapambetura. Firmat e ndërtimit (si *D+G Konstruksion* dhe *Duro Shpk*) mbeten debitorët më të mëdhenj për vitin 2024, me shuma që kalojnë 130,000 lekë secila.
56. Viti 2024 ka pasur një aktivitet të lartë të faturimit të tarifave vendore (pastrim, ndriçim, gjelbërim, tabelë). Shumë subjekte kanë treguar korrektësi duke likuiduar detyrimet brenda vitit kalendarik.
1. Raifaissen Bank: 281,990 lekë (Likuiduar me 23.01.2024).
  2. Selenica Bitum Gravel: 110,120 lekë (Likuiduar me 18.06.2024).
  3. Erseka Solar Park (2 & 3): Rreth 167,000 lekë total (Likuiduar Shkurt-Mars 2024).
57. Një grup subjektësh nuk arritën të paguanin brenda vitit, duke krijuar një stok debie prej rreth 540,000 lekë vetëm nga 6-7 subjektet kryesore (si *Alned 91*, *D+G Konstruksion*, *Rehovari*, *Duro Shpk*). Viti 2025 deri tani shërben si vit likuidimi për prapambetjet e vitit 2024.
58. Likuidimet e Suksesshme në 2025:
1. Arion OIL (Z. B.): Shleu detyrimin prej **57,799 lekë** menjëherë në fillim të vitit (16.01.2025).
  2. 6 Korriku: Shleu detyrimin e plotë bashkë me kamatën (**88,760 lekë**) në Gusht (15.08.2025).
59. Për vitin 2025, është aplikuar një penalitet mesatar prej **10.8%** mbi vlerën bazë për subjektet që mbartën debinë nga viti 2024. Këto subjekte rezultojnë ende me detyrime të pashlyera në sistem deri në përditësimin e fundit të listave:

Subjekti	Debia Bazë 2024	Kamata 2025	Total i mbetur
Duro Shpk	123,350 lekë	13,320 lekë	136,670 lekë
D+G Konstruksion	119,270 lekë	12,870 lekë	132,140 lekë
Rehovari	91,290 lekë	9,846 lekë	101,136 lekë
Alned 91	70,540 lekë	7,614 lekë	78,154 lekë

Pasqyra Nr. 5 e Debitorëve Aktivë (Mbetja për 2025)

60. Ka një rritje të ndërgjegjësimit për pagesat në fillim të vitit 2025, por firmat e ndërtimit (Konstruksionet) mbeten pika më problematike me detyrimet më të larta. Për subjektet si *Duro Shpk* dhe *D+G Konstruksion*, të cilat kanë detyrime mbi 130,000 lekë, duhet dërguar njoftimi i dytë për ekzekutim të detyrueshëm, pasi kamata do të vazhdojë të rritet.
61. Sipas të dhënave të procesura nga lista e bizneseve fizike rezulton se, numri i bizneseve me borxh (Debi) nga 2024 është 137 subjekte. Shumica e bizneseve në listë kanë shlyer detyrimet e vitit 2025, por një pjesë e konsiderueshme mbartin ende shifra në kolonën e debisë së vitit të kaluar.

Emri / Mbiemri	NIPT	Debia 2024 (Lekë)
P. B	K37508042L	Rezulton me detyrime të larta
V. F	M37604001B	Rezulton me detyrime të larta
Xh. C	K57512081R	Rezulton me detyrime të larta
A. H	L57602001P	Rezulton me detyrime të larta

*Tabela Nr.6 Subjektet që rezultojnë me debi të regjistruar nga viti 2024*

62. Nga këqyrja e të dhënave vihet re se Njësia e Audituar ka arritur të mbledhë me sukses këstet e para dhe të dyta për vitin 2025 (shumë subjekte janë "0" në debi), por kolona "Debia 2024" tregon se ka ende nevojë për ndjekje administrative për vitin e kaluar. Është përgatitur një listë "Rinjoftimi", ku përfshihen emrat që kanë detyrime, me qëllim dërgimin e njoftim-pagesave zyrtare. Numri i bizneseve me detyrime (Debi > 0) për vitin 2024, është 89 subjekte, ndërsa shuma Totale e Debisë së prapambetur: 1,008,185 Lekë.

Nr.	Emri / Mbiemri	NIPT	Aktiviteti	Debia 2024 (Lekë)
1	V.F	M37604001B	Bar-Kafe	133,000
2	P. B	K37508042L	Bar-Restorant	110,000
3	G. E	K37512051P	Bar-Restorant	86,000
4	P.M	K37505085G	Bar-Kafe	42,000
5	S.K	M07901001H	Bar-Restorant	42,000
6	A. H	L57602001P	Bar-Restorant	42,000
7	Xh. C	K57512081R	Bar-Kafe	38,000
8	E. K	K87503042N	Bar-Kafe	30,000
9	R. P	K37511051J	Bar-Restorant	30,000
10	S.A	K67503082U	Bar-Kafe	26,000

*Tabela Nr.7 10 Debitorët më të mëdhenj (Viti 2024)*

63. Vihet re se borxhet më të mëdha vijnë nga sektori i Bar-Restoranteve dhe Bar-Kafeve. Kjo tregon që këto kategori kanë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve vjetore brenda afateve, ose kërkojnë një vëmendje më të shtuar për vjeljen e taksave (pastrim, ndriçim, etj.). Vlera mesatare e debisë për subjekt është rreth 11,300 Lekë. Shumica e bizneseve të tjera (rreth 110+ subjekte) rezultojnë me Debi 0, që do të thotë se janë të rregullt me pagesat e prapambetura. Bazuar në të dhënat e dokumentacionit mbi Bizneset Juridike për Bashkinë Kolonjë, viti 2025 paraqitet si një vit me aktivitet të lartë fiskal dhe një strukturë të qartë të detyrimeve dhe pagesave për subjektet

juridike. Kryesisht subjektet kanë operuar në disa sektorë të tillë si: Sektori Bankar, institucione si Raiffeisen Bank dhe Fondi BESA, të cilat kanë detyrimet më të larta financiare (p.sh. detyrimi i Raiffeisen Bank kap shifrën **281,990 lekë**); Ndërtimi dhe Infrastruktura, firma si A.N.K shpk dhe kompani karburanti si Kastrati; Bujqësia dhe Blegtoria, subjekte si Gjonci Bio Shpk dhe Agro Farm Luarasi (Fermë blegtoriale), që tregojnë peshën e këtij sektori në ekonominë lokale dhe Energjia, ku dallon prania e subjekteve si “Razdoll Hidro vizion” (HEC).

64. Nga analiza e kolonave të detyrimeve, vihet re se struktura e taksimit përbëhet nga disa elementë kyç, Tarifa e Pastrimit dhe Ndriçimit si tarifat bazë që paguhen nga pothuajse çdo subjekt, Taksa mbi Ndërtesën/Pasurinë si variabla kryesore që rrit shumën totale të detyrimit dhe Detyrimet e Prapambetura (Debia), ku disa subjekte kanë mbartur debi nga vitet e kaluara, e cila është shlyer ose është në proces shlyerjeje gjatë vitit 2025. Një pjesë e madhe e subjekteve (si D. Xh, Raiffeisen, Kastrati) i kanë shlyer detyrimet e tyre plotësisht (shënuar me "0" në kolonën debitore 2025), kryesisht përmes llogarive bankare, me data pagesash që shtrihen përgjatë gjithë vitit (nga janari deri në nëntor 2025). Nga dokumentacioni i administruar, rezulton një proces administrativ aktiv për Rinjoftimet e Biznesit Juridik 2025, përmes listave të sakta. Kjo listë përfshin 16 subjekte që kërkojnë vëmendje të veçantë nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave.







Subjekti	Veprimtaria	Detyrimi Total (Lekë)	Statusi
<b>Raifaizen Bank</b>	Bankë	281,990	E paguar
<b>Kastrati</b>	Karburant	182,350	E paguar
<b>Fondi BESA</b>	Bankë	150,120	E paguar
<b>Gjonci Bio</b>	Blegtori	80,120	E paguar

*Tabela Nr.8 Përmbledhëse*

65. Nga të dhënat e procesuara, viti 2025 rezulton me një vëllim të konsiderueshëm arkëtimesh, ku shuma totale e arkëtuar kap vlerën rreth **2,245,670 lekë**. Pjesa dërrmuese e bizneseve juridike (mbi 85%) rezultojnë me debi 0, që do të thotë se janë treguar korrektë me pagesat brenda vitit kalendarik.
66. Subjektet e mëposhtme kanë derdhur shumat më të mëdha në arkën e bashkisë për vitin 2025:
1. Raiffeisen Bank: 281,990 lekë.
  2. Kastrati shpk: 182,350 lekë.
  3. Banka BESA: 150,120 lekë.
  4. A.N.K shpk (Ndërtim): 115,400 lekë.
  5. Gjonci Bio Shpk: 80,120 lekë.
67. Sipas të dhënave të administruara, të ardhurat vijnë kryesisht nga Tarifa e Pastrimit që përbën peshën kryesore të detyrimit vjetor për çdo biznes, Taksa e Tabelës, që ka vlerë konstante (zakonisht 4,500 lekë ose 12,000 lekë për subjektet e mëdha) dhe Taksa e Ndërtesës, aty ku subjektet kanë prona të regjistruara, kjo taksë rrit ndjeshëm vlerën e faturës (si në rastin e

bankave dhe pikave të karburantit). Nga Rinjoftimet, vërehet se se Njësia ka qenë aktive në monitorimin e subjekteve që mund të kenë pasur ndryshime në status (aktiv/pasiv) dhe bizneseve që kanë ndërruar vendndodhjen ose aktivitetin (p.sh. lokale që kthehen në zyra ose anasjelltas).

68. Viti 2025 paraqitet si një vit shumë i suksesshëm për arkëtimet e bizneseve juridike. Nuk vihen re vonesa kritike në pagesa nga bizneset e mëdha, gjë që siguron likuiditet të qëndrueshëm për investimet lokale të bashkisë

Subjekti	Kontributi (Lekë)	Grafiku (Relativ)
Raiffeisen Bank	281,990	 100%
Kastrati shpk	182,350	 65%
Banka BESA	150,120	 53%
A.N.K shpk	115,400	 41%
Gjonci Bio	80,120	 28%
Të tjerë (Mesatarja)	35,000	 12%

*Tabela Nr.9 Përmbledhëse*

69. Nëse do ta ndanim grafikun e të ardhurave të vitit 2025, do të dukej përafërsisht kështu:

1. Sektori Bankar (Financiar): 45% (*Bankat paguajnë tarifatat më të larta për shkak të taksës së ndërtesës dhe tabelave*)
2. Karburantet & Energjia: 20% (*Kastrati dhe subjektet e HEC-eve*)
3. Ndërtimi & Infrastruktura: 15% (*Kompanitë e ndërtimit me projekte aktive*)
4. Agropërpunimi & Shërbimet: 20% (*Fermtat, subjektet tregtare dhe bizneset e vogla juridike*)

70. Vihet re se 3 subjektet e para (Raiffeisen, Kastrati, BESA) mbulojnë pothuajse 30% të të gjithë buxhetit që vjen nga biznesi juridik. Kjo tregon se suksesi i mbledhjes së të ardhurave në Bashki varet shumë nga marrëdhënia me këta lojtarë të mëdhenj.

Emri i Subjektit	Lloji i Aktivitetit	Debia e Bartur/Mbartur	Shënime Administrative
B. Gj	Tregtëi	42,488 lekë	Ka debi të mbartur që duhet verifikuar.
S.B	Shërbime	12,000 lekë	Detyrim i papaguar për tarifën e tabelës/pastrimit.
K. Z	Tregëti Karburanti	-	Ka shlyer 2025, por ka verifikim për periudhat e kaluara.
Subjekte të tjerë	Diverse	<i>Rinjoftim</i>	16 subjekte kërkojnë dërgimin e njoftim-pagesës së re.

*Tabela Nr. 20 Lista e Subjekteve me Detyrime/Debi (Viti 2025)*

71. Bazuar në dokumentet e administruara për Biznesin Fizik 2024, për subjektet e listuara, detyrimet vjetore përfshijnë Taksën e Pasurisë, Pastrimit, Ndriçimit dhe Tabelës. Pagesat janë të ndara në dy këste (Kësti I dhe Kësti II). Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve (si p.sh. A. dhe A. C) kanë shlyer detyrimet e tyre të plota për vitin 2024, duke rezultuar me debi 0 në fund të vitit.
72. Aktivitetet dominuese që mbajnë peshën e biznesit fizik në këtë zonë janë ato Ushqimore dhe Tregti që përbëjnë numrin më të madh të subjekteve, Shërbimet ( kryesisht Bar-Restorant) me detyrime relativisht më të larta (p.sh. subjekti P. B me detyrim mbi 43,000 lekë) dhe Prodhues dhe Artizanë që përfshijnë aktivitete si "Art Industriale", "Marangoz" dhe "Punime Duralumin".
73. Debitorët e Biznesit Fizik 2024, të cilët mbartin detyrime për vitin pasardhës, paraqiten si më poshtë:

Subjekti	Aktiviteti	Detyrimi 2024	Kamata	Totali (Pagesa 2025)
A. M	T. Udhetare	8,060	336	8,396
A. C	Mekanik	26,760	2,560	29,320
D.M	Kabllor	32,560	1,365	33,925
V.Sh	Duralumin	29,370	2,816	32,186

Tabela Nr. 11 Debitorët e Biznesit Fizik 2024

74. Kamat-vonesat aplikohen mbi detyrimet e papaguara, duke rritur barrën fiskale për këto subjekte mesatarisht me 5-10% të vlerës fillestare. Pjesa dërrmuese e bizneseve të rregullta i shlyejnë detyrimet brenda afateve të kësteve (Mars-Tetor). Bizneset me aktivitet specifik (si shërbimet e kabllorit apo mekanikët) paraqesin nivele më të larta debie dhe vonesa në pagesa. Vërehet se ka një numër të konsiderueshëm subjektsh të reja të regjistruara gjatë vitit 2024, gjë që tregon një lëvizshmëri të aktivitetit ekonomik lokal.
75. Nga përpunimi i listave, vërehet një ndarje e qartë mes bizneseve korrekte dhe atyre që kanë krijuar vonesa. Shumica e bizneseve të vogla (ushqimore, rrobaqepësi) kanë likuiduar Këstin I dhe Këstin II brenda afateve, duke përfituar nga mbyllja e vitit pa kamata. Një grup prej rreth 25 subjektsh janë transferuar si debitorë për vitin pasardhës. Për bizneset që nuk kanë paguar në kohë, kamata mesatare e aplikuar sillet rreth 4% - 8% të vlerës së taksës bazë (p.sh. për një detyrim prej 26,000 lekësh, kamata është mesatarisht 2,500 lekë).

Sektori	Karakteristika	Statusi i Pagesave
Tregti me Pakicë	Ushqimore, fruta-perime	Shlyerje e lartë (mbi 85%)
Shërbime	Bar-Kafe, Berber, Mekanik	Nivel mesatar debitorësh
Transport/Kabllor	Shërbime specifike	Vlerat më të larta të detyrimeve individuale

Tabela Nr. 12 Struktura e Bizneseve (3 Sektorët Kryesorë)

76. Disa subjekte kanë vlera të konsiderueshme të papaguara që mbartin vitin 2024, ku vlerat më të larta vërhen te subjekte si *D. M* dhe *V. Sh* kanë detyrime që kalojnë 30,000 lekë (përfshirë kamatën). Subjektet me taksë table të thjeshtë (rreth 1,500 - 3,000 lekë) kanë shkallën më të lartë të korrektësisë.

Kategoria	Vlera në Lekë
Detyrimi Total i Lindur (2024)	1,142,450 lekë
Totali i Arkëtuar (Pagesat e kryera)	894,320 lekë
Detyrimi i Mbetur (Debitorët)	248,130 lekë
Kamatë vonesat e llogaritura	18,450 lekë

Tabela Nr.13 Përmbledhja Financiare Totale 2024

77. Kësti i Parë (I) është vjelë në masën 92%, që tregon një fillim viti shumë të mbarë për arkën e bashkisë. Kësti i Dytë (II), ka një rënie të arkëtimit, ku rreth 15% e bizneseve e kanë lënë pagesën përtej afateve zyrtare. Taksat e Pastrimit dhe ajo e Ndriçimit përbëjnë rreth 70% të vlerës totale të arkëtuar.
78. Shuma prej **248,130 lekësh** që ka mbetur pa u mbledhur vjen kryesisht nga subjektet me detyrime të mbartura (që nuk kanë paguar asnjë këst), subjektet që kanë mbyllur aktivitetin gjatë vitit por nuk kanë bërë çregjistrimin në bashki. Bazuar në regjistrin e detyrimeve dhe listën e debitorëve për vitin 2024, këto janë 10 subjektet me borxhin më të lartë të papaguar (përfshirë taksën bazë dhe kamatë-vonesën e llogaritur).

Nr.	Emri i Subjektit	Aktiviteti	Detyrimi Bazë	Kamata	Totali i Borxhit
1	<b>D. M</b>	Kabllor	32,560	1,365	<b>33,925 lekë</b>
2	<b>V.Sh</b>	Duralumin	29,370	2,816	<b>32,186 lekë</b>
3	<b>A. C</b>	Mekanik	26,760	2,560	<b>29,320 lekë</b>
4	<b>P.B</b>	Bar-Restorant	24,150	1,930	<b>26,080 lekë</b>
5	<b>B. G</b>	Lavazh/Goma	18,400	1,472	<b>19,872 lekë</b>
6	<b>A. K</b>	Tregti	15,200	1,216	<b>16,416 lekë</b>
7	<b>F. B</b>	Marangoz	12,850	1,028	<b>13,878 lekë</b>
8	<b>A. M</b>	T. Udhetare	8,060	336	<b>8,396 lekë</b>
9	<b>S. L</b>	Bar-Kafe	7,450	596	<b>8,046 lekë</b>
10	<b>E. H</b>	Tregti	6,200	496	<b>6,696 lekë</b>

Tabela Nr. 14 10 Debitorët Kryesorë për Vitin 2024

79. Tre subjektet e para (M, S, C) mbartin rreth **40%** të borxhit total të kësaj liste. Shihet se aktivitetet e rënda (Mekanik, Duralumin) dhe shërbimet e shtrirë (Kabllor) kanë vështirësinë më të madhe në likuidim. Për disa subjekte, kamata ka kaluar pragun e **8%** të vlerës, duke e bërë borxhin të rritet ndjeshëm për vitin 2025

80. Bazuar në të dhënat e administruara për Juridiket viti 2024, janë të regjistruar subjekte të ndryshme me status "Rezident" ose me "Kontratë Prokurimi". Ndër aktivitetet kryesore vërehen Sektori Bankar, Raiffeisen Bank, etj; Ndërtim dhe Infrastrukturë, A.N.K shpk, Salillari shpk, etj; Energji, Erseka Solar Park (2 dhe 3); Shërbime/Tregti, Farmaci, Internet (Fastnet Albania), etj. Nga të dhënat rezulton një performancë e mirë e vjeljes së të ardhurave për subjektet e listuara në fillim të vitit:

Subjekti	Detyrimi Total (Lekë)	Pagesa e Kryer	Statusi (Debitor)
<b>Raifaizen Bank</b>	281,990	281,990	0
<b>A.N.K shpk</b>	100,000	100,000	0
<b>Salillari shpk</b>	100,000	100,000	0
<b>Erseka Solar Park 2</b>	83,444	83,444	0
<b>Donika Xhelili</b>	18,120	18,120	0

*Tabela Nr.15 Juridiket viti 2024*

81. Bashkia aplikon disa lloje tarifash që përbëjnë detyrimin total të biznesit, ku vërhet Tarifa e Pastrimit e cila varjon sipas madhësisë/llojit të biznesit (p.sh. 15,000 - 100,000 Lekë); Tarifa e Ndriçimit, përgjithësisht rreth 3,000 - 50,000 Lekë për subjektet e mëdha; Tarifa e Tabelës një tarifë fikse (shpesh 120 Lekë për subjekte të vogla) dhe Tarifa e Hapësirës Publike, e aplikuar specifikisht për subjekte që shfrytëzojnë ambientet e jashtme.
82. Pjesa dërrmuese e subjekteve kanë shlyer detyrimet e tyre 100% brenda pjesës së parë të vitit (Janar - Qershor 2024). Shumica e transaksioneve janë kryer përmes bankës, duke treguar një formalizim të lartë të pagesave për subjektet juridike. Prania e parqeve solare (Erseka Solar Park) tregon një fokus të ri në investimet e gjelbra në zonë, të cilat kontribuojnë rreth 83,444 Lekë secila në buxhetin e tarifave vendore.

Subjekti	Detyrimi Total (Lekë)	Shuma e Paguar	Debia (Mbetje)
<b>B.M.N SHPK</b>	100,000	0	<b>100,000</b>
<b>GJO-SPA SHPK</b>	100,000	0	<b>100,000</b>
<b>KACDEDAJ SHPK</b>	100,000	0	<b>100,000</b>
<b>EURO-ALB SHPK</b>	100,000	0	<b>100,000</b>
<b>G.A.C.A SHPK</b>	100,000	0	<b>100,000</b>

*Tabela Nr. 16 Subjektet që kanë detyrimet më të mëdha të prapambetura 2024*

83. Vërehet se subjektet me kontrata prokurimi (shumica me detyrim standard 100,000 Lekë) kanë nivelin më të ulët të shlyerjes krahasuar me subjektet rezidente.
84. Nga struktura e të ardhurave, peshën kryesore e zënë përkatësisht Tarifa e Pastrimit rreth 65% të totalit të detyrimeve, Tarifa e Ndriçimit rreth 20% dhe Tarifa e Gjelbërimit/Tabelës/Hapësirës pjesën e mbetur prej 15%.

85. Niveli i vjeljes prej 47.7% sugjeron se Njësia ka nevojë për një strategji më aktive ndaj subjekteve me kontrata prokurimi (shpk-të), të cilat përbëjnë pjesën dërrmuese të debisë aktuale. Subjektet lokale "Rezidente" (si bankat, farmacitë dhe dyqanet e vogla) tregojnë një korrektësi shumë më të lartë në pagesa.

Emri i Subjektit	Lloji	Detyrimi Total (Lekë)
B.M.N SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
GJO-SPA SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
KACDEDAJ SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
EURO-ALB SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
G.A.C.A SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
4 AM SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
2 T SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
M.C.Q.C	Kontratë Prokurimi	100,000
DRINI 1000	Kontratë Prokurimi	100,000
REGLI SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
VANTEK SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
SHTYPSHKRONJA PEGI	Kontratë Prokurimi	100,000
GLOBAL-ENGINEERING	Kontratë Prokurimi	100,000
NIDAL SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION	Kontratë Prokurimi	100,000
PE-VLA-KU SHPK	Kontratë Prokurimi	100,000
ALB-ESTATE SHPK	Kontratë Prokurimi	50,000
SARA-EL SHPK	Kontratë Prokurimi	50,000
MIMOZA ISUFI	Rezident (Farmaci)	26,120
ALMA CENKOLLI	Rezident (Farmaci)	18,120

Tabela Nr.17 Lista e Debitorëve 100% (Asnjë pagesë e kryer)

86. Shuma totale e papaguar nga kjo listë është **1,744,240 Lekë**. Vërehet se pjesa dërrmuese e borxhit vjen nga kompanitë e ndërtimit apo shërbimeve me "Kontratë Prokurimi". Këto subjekte kanë detyrimin fiks prej 100,000 Lekë (kryesisht tarifa pastrimi dhe ndriçimi). Edhe pse shumat janë më të vogla, dy farmaci rezultojnë ende me detyrim të plotë.
87. **Titulli i Gjetjes:** Mungesë e arkëtimit të detyrimeve nga subjektet me kontrata prokurimi (shkalla e vjeljes 0%).

Nr. i Gjetjes 9	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave

<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” <i>(i ndryshuar)</i></li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> U konstatua se 16 subjekte juridike (kryesisht SHPK), të cilat kanë përfituar kontrata prokurimi nga institucioni, nuk kanë shlyer asnjë tarifë vendore për vitin 2024. Ky grup përbën riskun më të lartë financiar me një vlerë të papaguar prej <b>1,744,240 lekë</b>, duke dëshmuar mungesë koordinimi midis Sektorit të Prokurimeve dhe Drejtorisë së Tatim-Taksave për kushtëzimin e likuidimeve.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” <i>(i ndryshuar)</i>.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Humbje e konsiderueshme e likuiditetit dhe dëmtim i të ardhurave të veta të Bashkisë.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë komunikimi ndërmjet zyrës së prokurimeve dhe drejtorisë së taksave; mosaplikimi i klauzolave frenuese në kontrata.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I lartë.
<b>Konkluzioni</b>	Njësia e Audituar nuk ka marrë masat për të siguruar mbledhjen e taksave nga kontraktorët e saj.
<b>Rekomandimi</b>	Të bëhet ndalimi i menjëhershëm i pagesave për këto subjekte deri në shlyerjen e plotë të debisë ose nënshkrimin e një marrëveshjeje shlyerjeje me këste.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

88. **Titulli i Gjetjes:** Mungesa e masave shtrënguese për debitorët me vonesa mbi 12-mujore.

**Nr. i Gjetjes 10**

<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002" Për sistemin e taksave vendore"(i ndryshuar).</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Nga analiza e listë-pagesave, rezulton se vetëm 4 subjekte (L.J, D.M, A.C dhe B.Z) mbartin mbi 60% të borxhit total të mbetur për kategorinë e tyre. Për këto subjekte, si dhe për firmat e ndërtimit "Duro Shpk" dhe "D+G Konstruksion" (me detyrime mbi 130,000 lekë secila), nuk janë aplikuar masat e ekzekutimit të detyrueshëm (bllokim llogarish/sekuestro) pavarësisht vonesave mbi 12-mujore.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002" Për sistemin e taksave vendore"(i ndryshuar).</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Rritja e borxhit dhe vjetrimi i debisë, duke e bërë atë të pamundur për t'u vjelë në të ardhmen.</p> <p><b>Shkaku:</b> Neglizhencë administrative në ndjekjen e hallkave të fundit të njoftim-pagesave dhe mungesë e dërgimit të njoftimeve për ekzekutim.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I lartë.
<b>Konkluzioni</b>	Procedurat administrative kanë mbetur vetëm në fazën e njoftimit, pa kaluar në fazën ligjore shtrënguese.
<b>Rekomandimi</b>	Të hartohen njoftimet për ekzekutim të detyrueshëm dhe të njoftohen bankat e nivelit të dytë për bllokimin e llogarive të këtyre subjekteve.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Menjëherë.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

89. Titulli i Gjetjes: Mospërbushje e objektivave të arkëtimit gjatë pjesës së dytë të vitit.

<b>Nr. i Gjetjes 11</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Plani Vjetor i të Ardhurave.</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> U konstatua një rënie drastike të performancës arkëtuese midis dy kësteve. Ndërsa Kësti I paraqet një shkallë vjeljeje prej <b>92%</b>, Kësti II tregon një rënie të ndjeshme ku rreth <b>15% e bizneseve</b> kanë kaluar në status debitori. Kjo tregon një rënie të monitorimit administrativ pas përfundimit të tremujorit të parë të vitit.</p> <p><b>Kriteri:</b> Plani Vjetor i të Ardhurave, i miratuar .</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mosrealizim i parashikimeve buxhetore dhe vonesa në financimin e projekteve të fundvitit.</p> <p><b>Shkaku:</b> Ulje e intensitetit të monitorimit pas periudhës së parë të vitit dhe mungesë e fushatave nxitëse për pagesat e këstit të dytë.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Kontrolli mbi vjeljen e taksave nuk është i qëndrueshëm përgjatë gjithë ciklit fiskal.
<b>Rekomandimi</b>	Të bëhet automatizimi i sistemit të njoftimit përmes SMS/E-mail për të gjithë subjektet që nuk paguajnë këstin e dytë brenda 15 ditëve nga afati zyrtar.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

90. Titulli i Gjetjes: Mosrakordim midis statusit aktiv të subjekteve në sistem dhe gjendjes reale në terren.

<b>Nr. i Gjetjes 12</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik.</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> U konstatua një stok debie prej <b>248,130 lekësh</b> te bizneset fizike, ku një pjesë e subjekteve rezultojnë debitorë vetëm për shkak të mungesës së çregjistrimit administrativ pas mbylljes së aktivitetit. Mungesa e verifikimeve periodike në terren ka çuar në mbartjen e borxheve të pambledhshme dhe fryrjen artificiale të llogarive të arkëtueshme.</p> <p><b>Kriteri:</b> Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik.</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Pasqyra financiare të pasakta që tregojnë asete (debi) të cilat në fakt nuk ekzistojnë.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesë e verifikimit periodik në terren (inventarizimi i bizneseve) dhe vonesa në rakordimin me QKB-në.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Regjistri i debitorëve është i paazhornuar, duke dëmtuar cilësinë e të dhënave financiare.
<b>Rekomandimi</b>	Të ngrihet një grup pune për verifikimin në terren të të gjithë debitorëve mbi 2-vjeçarë dhe të bëhet fshirja e debisë sipas procedurave ligjore për bizneset që vërtetohen të mbyllura.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Brenda vitit 2026
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

91. Titulli i Gjetjes: Mosarkëtimi i plotë i detyrimeve financiare në sektorin “Bar-Restorant”

<b>Nr. i Gjetjes 13</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Sektori i shërbimeve (Bar-Kafe/Restorante) rezulton me numrin më të madh të subjekteve debitorë (89 subjekte). Aplikimi i kamatëvonesave prej 8-12% ka rritur barrën fiskale të tyre, por pa rritur shkallën e arkëtimit, gjë që kërkon një rishikim të strategjisë së vjeljes për këtë kategori specifike.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar) (Parimi i efincës)</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Kamata po shndërrohet në një barrë që bllokton pagesën e detyrimit bazë, duke rritur mospagimin sistematik.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mungesa e një strategjie specifike .</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Metoda aktuale e aplikimit të kamatë vonesës, nuk është funksionale për arkëtimin në këtë kategori.
<b>Rekomandimi</b>	Të merren masa për vjeljen dhe arkëtimin e plotë të detyrimeve në këtë sektor.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

### **Opinion i përgjithshëm:**

92. *Analiza e performancës financiare tregon një kontrast të fortë midis kategorive të ndryshme të tatimpaguesve. Ndërsa bizneset juridike rezidente dhe institucionet financiare si Raiffeisen Bank apo Fondi BESA shfaqin një korrektësi të lartë në pagesa duke siguruar pjesën dërrmuese të likuiditetit, situata paraqitet problematike te subjektet me kontrata prokurimi. Është konstatuar se këto subjekte, të cilat përfitojnë fonde nga buxheti i bashkisë, kanë një shkallë vjeljeje prej 0% për taksat vendore, gjë që dëshmon për një mungesë të rëndë koordinimi administrativ dhe dështim të kontrollit të brendshëm në kushtëzimin e pagesave ndaj kontraktorëve.*
93. *Për sa i përket dinamikës së arkëtimit gjatë ciklit vjetor, vërehet një rënie e vrullit administrativ pas përfundimit të tremujorit të parë. Shifrat tregojnë se ndërsa Kësti i Parë vilet në masën 92%, Kësti i Dytë pëson një rënie drastike ku rreth 15% e bizneseve kalojnë automatikisht në status debitori. Ky fenomen sugjeron se administrata nuk aplikon një monitorim të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit dhe se sistemi i njoftimeve nuk është i automatizuar, duke e lënë suksesin e mbledhjes së të ardhurave në varësi të vullnetit fillestar të subjekteve në fillim të vitit fiskal.*
94. *Një shqetësim kritik për cilësinë e raportimit financiar është stoku i debisë së bartur, veçanërisht në sektorin e biznesit fizik. Auditimi konstaton se një pjesë e konsiderueshme e borxhit prej 248,130 lekësh mund të jetë fiktive, pasi shumë subjekte rezultojnë aktive në sistem ndonëse në realitet e kanë mbyllur aktivitetin pa u çregjistruar zyrtarisht. Kjo mungesë rakordimi me terrenin dhe QKB-në çon në fryrjen artificiale të llogarive të arkëtueshme në bilanc, duke paraqitur një situatë financiare që nuk përputhet me asetet reale që bashkia ka mundësi të arkëtojë.*
95. *Sektori i shërbimeve, specifikisht Bar-Restorantet, përfaqëson kategorinë me numrin më të lartë të debitorëve, ku kamatëvonesat prej 8-12% po rezultojnë joefektive. Në vend që të nxisin pagesën, këto penalitete po shndërrohen në një barrë financiare të papërballueshme që bllokun shlyerjen e detyrimit bazë.*
96. *Si përfundim, sistemi kërkon një ndërhyrje të menjëhershme për të rritur forcën ekzekutuese dhe saktësinë e të dhënave. Rekomandohet ngritja e grupeve të punës për verifikimin në terren dhe pastrimin e regjistrimit nga bizneset e mbyllura, si dhe implementimi i klauzolave frenuese në kontratat e prokurimit. Pa një automatizim të procesit të rinjoftimit dhe pa një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet zyrës së taksave dhe asaj të prokurimeve, stoku i debisë do të vazhdojë të vjetërohet, duke rritur rrezikun që këto të ardhura të humbasin përfundimisht për buxhetin lokal.*

## 4.2 SISTEMI PËR TARIFAT DHE TAKSAT E FAMILJEVE

97. Situata financiare e detyrimeve familjare për Njësinë Administrative Leskovik në vitin 2024 paraqitet me një volum total prej 578,538 Lekë. Kjo shumë është e shpërndarë në 164 familje debitore, duke krijuar një mesatare detyrimi prej rreth 3,527 Lekë për familje. Ky borxh përfaqëson një sërë taksash dhe tarifash vendore që kanë mbetur pa u arkëtuar deri në fund të periudhës raportuese, duke ndikuar drejtpërdrejt në buxhetin e planifikuar të Bashkisë Kolonjë për investime lokale.
98. Struktura e borxhit dominon kryesisht nga Tarifa e Pastrimit dhe Tarifa e Mirëmbajtjes së Rrugëve, të cilat së bashku përbëjnë më shumë se gjysmën e vlerës totale (rreth 328,700 Lekë). Kjo tregon se shërbimet publike bazë janë ato që kanë koston më të lartë të papaguar nga qytetarët. Ndërkohë, taksat mbi pronën (ndërtesa dhe toka) kanë një peshë më të vogël, gjë që mund të reflektojë ose vlerësimin e ulët të pasurisë në zonë, ose një disiplinë pak më të lartë në pagesat e taksave mbi pasurinë krahasuar me tarifat e shërbimeve.
99. Përveç tarifave të shërbimeve, një zë i rëndësishëm është Tarifa e Druve të Zjarrit, e cila kap vlerën e 93,000 Lekëve. Duke qenë se Leskoviku është një zonë malore me nevoja të larta për ngrohje gjatë dimrit, kjo tarifë mbetet një barrë financiare për shumë familje. Mosshlyerja e kësaj tarife tregon vështirësitë ekonomike të zonës për të mbuluar kostot bazë të jetesës, veçanërisht gjatë muajve të ftohtë kur shpenzimet rriten.
100. Në fund, vërehet se numri i debitorëve është relativisht i lartë për një njësi administrative si Leskoviku. Prania e 164 familjeve në listë sugjeron se borxhi nuk është i përqendruar vetëm te disa individë, por është një fenomen i përhapur në një pjesë të konsiderueshme të komunitetit. Ky shpërndarje kërkon një strategji komunikimi dhe mbledhjeje të detyrimeve që të marrë parasysh statusin social të banorëve, pasi shumë prej tyre mund të kenë vështirësi objektive në shlyerjen e menjëhershme të borxheve.
101. Në krye të listës së debitorëve renditen 10 familje, detyrimet e të cilave variojnë nga 8,594 Lekë deri në 9,472 Lekë. Në krye të kësaj liste ndodhen individë si H. K. dhe H. D., të cilët mbartin peshën më të madhe financiare. Këta debitorë "të lartë" janë kritikë për procesin e vjeljes, pasi shlyerja e detyrimeve prej tyre do të përmirësonte ndjeshëm balancën financiare të njësisë administrative brenda një kohe të shkurtër.
102. Duke parë zbërthimin e detyrimeve për këtë grup, vihet re se pothuajse të gjithë kanë një detyrim fiks prej 3,000 Lekësh për Drutë e Zjarrit, plus tarifat maksimale për pastrimin dhe rrugët. Kjo tregon se këto familje mund të kenë sipërfaqe më të mëdha ndërtimi ose toke, ose janë klasifikuar në kategori tarifore më të larta. Për shembull, rasti i I. N., i cili ka taksën më të lartë të ndërtesës (1,529 Lekë) në këtë grup, sugjeron një pronë me vlerë më të lartë se mesatarja.

103. Një karakteristikë e përbashkët e këtij grupi është se ata kanë detyrime në të gjitha kategoritë e taksave dhe tarifave. Ndryshe nga debitorët e vegjël që mund të kenë harruar vetëm një taksë specifike (psh. taksën e varrezave), këta 10 individë nuk kanë kryer asnjë pagesë për vitin 2024. Kjo mund të jetë tregues i një refuzimi sistematik për të paguar detyrimet ose i një pamundësie totale financiare për të përballuar kostot e jetesës në qytet.
104. Nëse Bashkia do të ndërmernte masa administrative, ky grup prej 10 personash do të ishte objektivi i parë. Megjithatë, duhet analizuar nëse këto shuma janë të mbartura edhe nga vitet e mëparshme apo janë akumuluar vetëm gjatë vitit 2024. Përqendrimi i vëmendjes te këta debitorë mund të shërbejë edhe si një mesazh për pjesën tjetër të komunitetit lidhur me rëndësinë e shlyerjes së detyrimeve lokale për mirëmbajtjen e shërbimeve publike.
105. Nga analiza e skedarit të parë (Sheet 1), rezulton se procesi i vjeljes së borxhit ka nisur dhe është aktiv. Janë identifikuar rreth 50 raste ku janë shënuar numrat e mandate-arkëtimeve dhe datat përkatëse. Vlen të theksohet se shumë nga këto pagesa mbajnë data të vitit 2025 (p.sh. shkurti, gushti apo tetori i vitit 2025), gjë që tregon se lista po përdoret si një dokument pune i gjallë për të ndjekur pagesat që kryhen me vonesë për vitin 2024.
106. Dokumentacioni përmban shënime specifike për vendndodhjen e arkëtimit, siç është rasti i shënimit "arka Ersekë", duke treguar se disa banorë të Leskovikut preferojnë ose detyrohen t'i kryejnë pagesat në qendrën e bashkisë. Ky detaj sugjeron se mund të ketë nevojë për lehtësimin e kanaleve të pagesës në vetë Njësinë Leskovik, për të inkurajuar banorët të shlyejnë detyrimet pa pasur nevojë të udhëtojnë në qytetin fqinj.
107. Një element social i rëndësishëm që del nga shënimet është identifikimi i personave me statusin "pensionist". Janë të paktën 13 raste ku ky status është shënuar direkt në listë, shpesh i shoqëruar me shuma të reduktuara ose me vështirësi në pagesë. Ky informacion është jetik për bashkinë, pasi mund të shërbejë si bazë për aplikimin e skemave të lehtësimit ose faljes së kamatë-vonesave për kategoritë e ndjeshme sociale.
108. Së fundi, vërehet se rreth 30% e listës fillestare ka kryer një formë likuidimi ose ka një shënim përcjellës. Kjo tregon një normë arkëtimi inkurajuese, por sërish mbetet një pjesë e madhe prej rreth 114 familjesh që nuk kanë asnjë shënim pagese.

Kategoria e Detyrimit	Vlera Totale (Lek)
Tarifa e Pastrimit	173,000
Tarifa e Mirëmbajtjes së Rrugëve	155,700
Tarifa e Druve të Zjarrit	93,000
Taksa e Ndërtesës (2024)	58,750
Taksa e Tokës	53,588
Tarifa e Mirëmbajtjes së Varrezave	44,500

*Tabela Nr. 1 Shpërndarja e vlerave totale për çdo lloj takse/tarife*

109. Në total, regjistri përmban të dhëna për 1,574 familje të shpërndara në 6 blloqe kryesore administrative të Ersekës. Për vitin 2024, performanca financiare tregon se detyrimet variojnë nga rreth 816,000 Lekë në Bllokun 3 deri në 1.76 milion Lekë në Bllokun 6. Shkalla e arketimit mesatare lëviz ndërmjet 43% dhe 52%, gjë që tregon se rreth gjysma e detyrimeve mbeten ende të papaguara (debi) deri në momentin e gjenerimit të këtyre raporteve. Blloku Nr. 1 paraqitet me shkallën më të lartë të arketimit (~51.7%), ndërsa Blloku Nr. 4 ka përqindjen më të ulët të mbledhjes së detyrimeve (~43.0%).
110. Detyrimet financiare për çdo familje janë të strukturuar në katër kategori kryesore: Tarifa e Pastrimit, e cila është komponenti kryesor (zakonisht 2000 Lekë); Tarifa e Ndriçimit (1800 Lekë); Taksa mbi Ndërtesën, e cila llogaritet mbi sipërfaqen në metër katror (me tarifë 8 Lekë/metër katror); dhe Tarifa e Mirëmbajtjes së Varrezave (500 Lekë). Nga analizat shihet se Tarifat e Pastrimit dhe Ndriçimit përbëjnë pjesën dërrmuese të arketimeve të rregullta, ndërsa Taksa e Ndërtesës pëson luhajtje më të mëdha varësisht nga statusi i familjes apo sipërfaqja e banimit.
111. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në regjistrë kanë status të veçantë social, ku janë identifikuar mbi 300 familje pensionistësh dhe rreth 60 familje me invaliditet ose KEMP. Një vëzhgim i rëndësishëm në të dhëna është se familjet me status "Pensionist" shpesh gëzojnë lehtësira fiskale, duke pasur detyrim 0 Lekë për taksën e ndërtesës, gjë që dëshmon aplikimin e politikave mbështetëse sociale nga bashkia. Megjithatë, vërehet një nevojë për standardizimin e shënimeve, pasi statusi është shënuar me forma të ndryshme (p.sh. "pensionist", "pensioniste", "invalid"). Nga analiza e të dhënave, përfundojmë se ka një hapësirë të konsiderueshme për përmirësimin e mbledhjes së detyrimeve, pasi mbi 45% e vlerës totale mbetet ende në formë debie.

Blloku	Nr. Familjeve	Detyrimi Total (Lek)	Pagesa e Kryer (Lek)	Shkalla e Arketimit
Blloku 1	329	1,507,273	779,947	51.7%
Blloku 2	192	858,910	399,303	46.5%
Blloku 3	184	816,119	420,417	51.5%
Blloku 4	281	1,276,138	549,123	43.0%
Blloku 5	200	895,435	408,501	45.6%
Blloku 6	388	1,764,414	882,851	50.0%

Tabela Nr.2 Analiza sipas Blloqeve

112. Gjatë muajit Janar 2024, administrimi i tarifave dhe taksave ka përfshirë një total prej 848 familjeve të regjistruara në listë. Nga pikëpamja financiare, vëllimi më i madh i të ardhurave gjenerohet nga tarifat e shërbimeve bazë, ku Pastrimi kryeson me 2,828,900 Lek, i ndjekur nga Ndriçimi me 2,532,400 Lek.
113. Ndërkohë, Taksa e Pasurisë dhe Mirëmbajtja e Varrezash kontribuojnë përkatësisht me rreth 581 mijë dhe 679 mijë Lek. Kjo analizë tregon një strukturë ku peshën kryesore të buxhetit e mbajnë shërbimet e mirëmbajtjes urbane, ndërsa vërehet se jo të gjithë banorët janë subjekt i taksës së pasurisë për këtë periudhë.
114. Për sa i përket detyrimeve të papaguara, lista identifikon një grup të veçantë debitorësh që mbartin shuma të konsiderueshme. Debitori më i madh është R. P në Blllokun 4 me një shumë prej 33,000 Lek, i ndjekur nga N. M në Blllokun 6 me 22,400 Lek. Gjithashtu, vihen re raste si O.B dhe Gj.V me detyrime mbi 12,000 Lek. Edhe pse numri total i personave me debi nuk është shumë i lartë në raport me totalin e familjeve, përqëndrimi i borxhit te këta individë kërkon një vëmendje të shtuar për arkëtimin e tyre me qëllim eliminimin e vrimave financiare.
115. Nga analiza e hollësishme e të dhënave vërehet një qëndrueshmëri në tarifat standarde të pastrimit dhe ndriçimit (kryesisht 2000 dhe 1800 Lek për familje), që tregon një aplikim uniform të tarifave vendore. Megjithatë, mbulimi i taksës së pasurisë duket i pjesshëm, pasi vetëm rreth 67% e familjeve rezultojnë me një vlerë të caktuar në këtë kolonë.
116. Një tjetër element i rëndësishëm është fakti se Blloku 6, përveçse ka numrin më të madh të banorëve, mbart edhe vlerën më të lartë të debisë totale (132,088 Lek), gjë që sugjeron se kjo zonë ka nevojë për një monitorim më të rreptë të procesit të arkëtimit.

Blloku	Nr. Familjeve	Pastrimi (Lek)	Ndriçimi (Lek)	Pasuria (Lek)	M. Varrezash (Lek)	Debia (Lek)
1	182	341,250	306,750	68,377	83,500	64,550
2	97	176,000	158,000	41,995	42,500	35,097
3	100	183,500	165,000	39,265	44,500	45,974
4	132	240,000	214,800	47,795	59,500	89,124
5	99	184,000	163,600	31,755	44,200	30,572
6	227	404,200	361,200	87,195	96,900	132,088

Tabela Nr.3 Përmbledhës.

117. Nga të dhënat e analizuarra për vitin 2025, rezulton se njësia e audituar, menaxhon një portofol prej 1,576 familjesh në qytetin e Ersekës, ku vihet re një strukturë sociale e larmishme e përbërë nga 75% familjarë të rregullt, rreth 21% pensionistë dhe 4% kategori në nevojë (Invalidë/Kemp). Nga pikëpamja financiare, qyteti ka një objektiv arkëtimi prej rreth 7.3 milionë lekësh për vitin 2025, me një detyrim mesatar prej 4,630 lekësh për familje (bazuar në

një sipërfaqe mesatare banimi prej 67 m<sup>2</sup>). Megjithëse shkalla aktuale e arkëtimit për vitin korrent qëndron në nivelin 41.67%, është për t'u shënuar progresi në vjeljen e prapambetjeve, ku deri më tani janë arkëtuar mbi 450,000 lekë debi nga vitet e kaluara, duke treguar një angazhim të shtuar për disiplinimin e pagesave të prapambetura.

Blloku	Nr. Familjeve	Detyrim Total (Lekë)	Pagesa 2025 (Lekë)	Shkalla e Arkëtimit (%)
Blloku 1	329	1,483,605	669,130	45.10%
Blloku 2	192	895,654	357,533	39.92%
Blloku 3	184	852,311	336,085	39.43%
Blloku 4	281	1,281,570	496,806	38.77%
Blloku 5	201	934,851	363,748	38.91%
Blloku 6	389	1,850,525	817,867	44.20%

*Tabela Nr.4 Analiza Sipas Bllqeve*

118. Nga përpunimi i të dhënave individuale të familjeve, rezulton se pesha kryesore e të hyrave vjen nga Pastrimi dhe Ndriçimi, të cilat së bashku kapin vlerën prej rreth 2,361,000 Lek. Kjo tregon se këto dy shërbime janë shtyllat kryesore të buxhetit të parashikuar.
119. Tarifa e Pasurisë (rreth 240,542 Lek) dhe ajo e Mirëmbajtjes së Varrezave (319,700 Lek) paraqesin shifra më të ulëta, gjë që mund të reflektojë ose tarifa më të vogla për njësi, ose një numër më të kufizuar familjesh që janë subjekt i këtyre taksave specifike. Një pikë kritike që vërehet në listë-pagesat e vitit 2025 është niveli i lartë i Debisë, e cila kap vlerën totale prej 941,131 Lek. Kjo shumë përfaqëson detyrime të prapambetura që nuk janë arkëtuar ende. Në krye të listës së debitorëve qëndrojnë individë si S. Gj (12,420 Lek) dhe Sh. B (12,100 Lek). Fakti që dhjetë debitorët më të mëdhenj kanë secili borxhe mbi 10,000 Lek, sugjeron se ka një akumulim të detyrimeve ndër vite, çka kërkon një strategji më aktive për mbledhjen e këtyre fondeve.
120. Struktura e dokumentit tregon një organizim të mirëfilltë sipas bllqeve, ku vihet re se Blloku 6 është zona me densitetin më të lartë të pagesave dhe familjeve. Mesatarisht, një familje paguan rreth 3,800 Lek në vit për shërbimet bazë (pastrim dhe ndriçim), një tarifë kjo që duket e standardizuar për pjesën dërrmuese të regjistrimeve. Megjithatë, prania e rreth 159 familjeve me debi të mbartur tregon se rreth 20% e totalit të familjeve kanë vështirësi ose vonesa në shlyerjen e detyrimeve, gjë që ndikon drejtpërdrejt në likuiditetin e fondeve për shërbimet publike.

Blloku	Numri i Familjeve
Blloku 6	170
Blloku 1	140
Blloku 4	110
Blloku 5	90
Blloku 2	80
Blloku 3	70

*Tabela Nr.5 Shpërndarja sipas Bllqeve*

121. Gjatë periudhës së analizuar, Njësia Administrative Leskovik ka arritur të arkëtojë një vlerë totale prej 434,178 Lekë. Kjo shumë është mbledhur përmes 89 transaksioneve të regjistruara, të cilat pasqyrojnë një përpjekje të ndjeshme për arkëtimin e detyrimeve. Një karakteristikë kryesore e këtij suksesi financiar është fokusimi te prapambetjet; pjesa dërrmuese e arkëtimeve i takon viteve 2024 (210,331 Lekë) dhe 2023 (179,076 Lekë), duke treguar se qytetarët janë në një proces aktiv të shlyerjes së detyrimeve të kaluara.
122. Ecuria e arkëtimeve gjatë vitit 2025 paraqitet me luhajtje sezonale të dallueshme. Muaji janar shënoi fillimin më të mbarë me 71,493 Lekë, ndjekur nga një rritje tjetër e ndjeshme në vjeshtë, ku shtatori dhe tetori grumbulluan përkatësisht 61,363 dhe 55,070 Lekë. Ky trend sugjeron se fluksi i pagesave rritet kryesisht në fillim të vitit dhe gjatë periudhës pas sezonit veror, duke u mbyllur me një performancë solide edhe në dhjetor (50,471 Lekë). Nga pikëpamja e llojit të taksës, të ardhurat dominohen nga shërbimet bazë të komunitetit. Pastrimi dhe Ndriçimi janë dy zërat kryesorë, duke kontribuar së bashku me mbi 60% të totalit (136,800 Lekë dhe 129,910 Lekë respektivisht). Kategoritë e tjera si taksa mbi ndërtesën (13.0%) dhe taksa mbi tokën (11.5%) mbajnë një peshë të rëndësishme, ndërsa zërat si dru zjarri, varreza dhe turizmi plotësojnë pjesën tjetër të buxhetit të arkëtuar.
123. Në listën e kontribuesve kryesorë, vërehen individë që kanë shlyer shuma të konsiderueshme, shpesh duke paguar për disa vite njëherësh. N. J kryeson listën me 39,373 Lekë, i ndjekur nga A.P me 36,340 Lekë. Paguesit e tjerë kryesorë si G. K, I. J dhe F. M, kanë kontribuar me shuma që variojnë nga 19,000 deri në 23,000 Lekë, duke luajtur një rol kyç në arritjen e objektivave të arkëtimit për njësinë. Një pikë mjaft pozitive është vullneti i qytetarëve për të likuiduar detyrimet e vjetra. Përveç arkëtimeve masive për vitet 2023 dhe 2024, në listë figurojnë edhe pagesa për vitin 2020 (25,220 Lekë) dhe madje deri në vitin 2019. Kjo tregon se administrata ka qenë efektive në ndjekjen e debitorëve.
124. Gjendja financiare e Njësisë Administrative Leskovik paraqet një sfidë të ndjeshme për arkën e Bashkisë Kolonjë, me një borxh total të akumuluar prej 1,148,385 Lek gjatë dy dekadave të fundit (2003-2023). Edhe pse gjatë vitit 2025 është vërejtur një lëvizje pozitive me shlyerjen e 171,936 Lekëve, shuma që mbetet ende e papaguar është mjaft e lartë, duke arritur në 976,449 Lek. Kjo do të thotë se deri më tani është arritur të vjelet vetëm rreth 15% e detyrimeve totale, duke kërkuar masa më të forta për inkasimin e pjesës së mbetur.

125. Struktura e borxhit tregon se peshën kryesore të detyrimeve e mbajnë tarifave të shërbimeve publike. Shërbimi i pastrimit kryeson me 360,900 Lek (rreth 31% të totalit), i ndjekur ngushtë nga ndriçimi publik me 339,610 Lek. Taksat mbi pronën, si ajo e tokës (211,822 Lek) dhe e ndërtesës (200,453 Lek), përbëjnë gjithashtu një pjesë të konsiderueshme të borxhit. Ndërkohë, taksa e turizmit paraqitet me vlerën më të ulët prej 35,600 Lek, gjë që pasqyron natyrën e zonës dhe llojin e tarifave që aplikohen mbi familjarët.
126. Nga lista prej 107 kryefamiljarësh, vihet re një përqendrim i borxhit te një grup i vogël individësh. Dhjetë debitorët kryesorë mbajnë një pjesë disproporcionale të detyrimit total. Fakti që këta dhjetë individë kanë detyrime që luhaten nga 27 mijë deri në mbi 43 mijë lekë, sugjeron se fokusimi i administratës te këto raste specifike mund të sjellë një përmirësim të menjëhershëm të bilancit financiar të njësisë. Naliza historike tregon se borxhi nuk është krijuar në mënyrë uniforme.
127. Një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve mbartin vjetërsi të lartë, duke filluar që nga periudha 2003-2013, çka vështirëson vjeljen e tyre për shkak të kalimit të afateve ligjore ose lëvizjes së popullsisë. Megjithatë, vihet re një rritje e akumulimit të borxhit në vitet e fundit, veçanërisht pas vitit 2020. Ky trend rritës në vitet e fundit tregon se mekanizmat e vjeljes së taksave kanë nevojë për rishikim, pasi borxhi po vazhdon të rritet pavarësisht pagesave sporadike që kryhen nga familjarët.
128. **Titulli i Gjetjes:** Mungesë efikasiteti në vjeljen e detyrimeve dhe administrim i dobët i debisë historike.

<b>Nr. i Gjetjes 14</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Shkalla e arketimit është e ulët (41% - 52%). Ekziston një debi e akumuluar prej 1,148,385 Lekësh në Leskovik që nga viti 2003, nga e cila është vjelë vetëm 15%. Dhjetë debitorët më të mëdhenj mbajnë peshën kryesore të borxhit (mbi 40,000 Lekë/secili) pa masa shtrënguese.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> ungesë likuiditeti për investime publike; rrezik i parashkrimit</p>

	(humbjes ligjore) të borxhit të vjetër; pabarazi fiskale mes qytetarëve. <b>Shkaku:</b> Mungesa e një strategjie për vjeljen e detyrueshme; mungesa e pikave të arkëtimit në njësi (banorët udhëtojnë në Ersekë); regjistrime manuale dhe jo-standarde të statusit të debitorëve.
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I lartë.
<b>Konkluzioni</b>	Nuk janë marrë masat e duhura ligjore ndaj debitorëve të mëdhenj dhe ka dështuar procesi i vjeljes, duke lejuar akumulimin e borxhit për më shumë se dy dekada.
<b>Rekomandimi</b>	Të nisnin procedurat e njoftim-pagesës dhe ekzekutimit për 10 debitorët kryesorë.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Menjëherë.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

129. **Titulli i Gjetjes:** Pasaktësi në administrimin e bazës së të dhënave dhe mungesë standardizimi në raportim.

<b>Nr. i Gjetjes 15</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Gjatë auditimit u konstatua se statusi i individëve (pensionist, invalid, KEMP) shënohet në forma të ndryshme dhe me gabime.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Vështirësi në nxjerrjen e statistikave të sakta për kategoritë që</p>

	përfitojnë lehtësi; rrezik për vendime të gabuara administrative; mungesë transparence në auditim. <b>Shkaku:</b> Mungesa e një sistemi softuerik të integruar (ERP) dhe mungesa e një manuali udhëzues për punonjësit e zyrës së arkës.
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni</b>	Administrimi manual dhe i pastandardizuar i të dhënave rrit probabilitetin për gabime njerëzore.
<b>Rekomandimi</b>	Të krijohet një regjistër elektronik me fusha të parazgjedhura për statusin social dhe të mos përdoret lista e vitit paraardhës për arkëtimet e vitit korrent.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	Në vijimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

130. **Titulli i Gjetjes:** Disproporcion i arkëtimet sipas zonave (Blloqeve) dhe mbulim i pjesshëm i Taksës së Pasurisë.

<b>Nr. i Gjetjes 16</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</li> </ul>
<b>Përshkrimi i gjetjes</b>	<p><b>Situata:</b> Vërehet një performancë e dobët në Bllokun 4 (shkalla më e ulët e arkëtimet 38.7% - 43%). Gjithashtu, vetëm 67% e familjeve rezultojnë si pagues të taksës së pasurisë (ndërtesë/tokë), ndërsa 100% e tyre paguajnë tarifë pastrimi.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji Nr.8982, datë 12.12.2002”Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar).</p>

	<b>Ndikimi/Efekti:</b> Problematika fiskalizimi. <b>Shkaku:</b> Mosrakordimi i të dhënave mes zyrës së urbanistikës, Kadastrës (ASHK) dhe zyrës së taksave; mungesë e inspektimeve në Bllokun 4.
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)</b>	I lartë.
<b>Konkluzioni</b>	Ekziston një boshllëk financiar në arkën e bashkisë për shkak të mosidentifikimit të plotë të bazës së taksueshme për pronat (ndërtesat).
<b>Rekomandimi</b>	Të kryhet një inventarizim fizik në terren, me prioritet blloqet problematike, të bëhet rakordimi i listës së pastrimit me listën e taksës së ndërtesës si dhe të kryhet përditësimi i sipërfaqeve të banimit në sistem.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit</b>	
<b>Statusi i rekomandimit</b>	

**Opinion i përgjithshëm:**

131. *Situata financiare e detyrimeve familjare për Njësinë Administrative Leskovik për vitin 2024 paraqitet me një vëllim total prej 578,538 Lekë. Kjo shumë është e shpërndarë në 164 familje debitore, duke krijuar një mesatare detyrimi prej rreth 3,527 Lekë për familje. Ky borxh përfaqëson taksa dhe tarifa të papaguara që ndikojnë drejtpërdrejt në buxhetin e planifikuar të Bashkisë Kolonjë për investime lokale.*
132. *Struktura e borxhit dominohet kryesisht nga Tarifa e Pastrimit dhe Tarifa e Mirëmbajtjes së Rrugëve, të cilat së bashku përbëjnë mbi 50% të vlerës totale (rreth 328,700 Lekë). Kjo tregon se shërbimet publike bazë janë ato që kanë koston më të lartë të papaguar. Ndërkohë, taksat mbi pronën (ndërtesa dhe toka) kanë një peshë më të vogël, gjë që mund të reflektojë vlerësimin e ulët të pasurisë në zonë ose një disiplinë më të lartë pagesash në këtë kategori.*
133. *Një zë specifik dhe i rëndësishëm është Tarifa e Druve të Zjarrit, e cila kap vlerën e 93,000 Lekëve. Duke qenë se Leskoviku është një zonë malore me nevoja të larta për ngrohje, kjo tarifë mbetet një barrë financiare për shumë familje. Mosshlyerja e saj dëshmon vështirësitë ekonomike të banorëve për të mbuluar kostot bazë të jetesës, veçanërisht gjatë muajve të ftohtë të dimrit. Në krye të listës renditen 10 familje me detyrime që variojnë nga 8,500 deri në 9,500 Lekë. Këta debitorë "të lartë" janë kritikë për procesin e vjeljes, pasi shlyerja e tyre do të*

*përmirësonte ndjeshëm balancën financiare në kohë të shkurtër. Vihet re se ky grup ka detyrime në të gjitha kategoritë, gjë që tregon një dështim sistematik për të kryer pagesat ose një pamundësi totale financiare.*

134. *Në qytetin e Ersekës, regjistri përmban 1,574 familje të ndara në 6 blloqe administrative. Performanca financiare tregon se shkalla e arkëtimit mesatare lëviz ndërmjet 43% dhe 52%. Blloku 1 paraqitet me shkallën më të lartë të arkëtimit (51.7%), ndërsa Blloku 4 ka përqindjen më të ulët (43%). Blloku 6, përveçse ka numrin më të madh të banorëve, mbart edhe vlerën më të lartë të debisë totale.*
135. *Një element pozitiv është identifikimi i mbi 300 familjeve pensionistësh dhe 60 familjeve me invaliditet. Të dhënat tregojnë se Bashkia aplikon politika mbështetëse, ku shumë pensionistë kanë detyrim 0 Lekë për taksën e ndërtesës. Megjithatë, vihet re nevoja për standardizimin e shënimeve në sistem, pasi statusi i tyre është shënuar në forma të ndryshme manuale, gjë që vështirëson procesimin automatik.*
136. *Gjatë vitit 2025 është vërejtur një ecuri inkurajuese në vjeljen e prapambetjeve, me rreth 434,178 Lekë të arkëtuara, ku përfshihen detyrime që datojnë deri në vitin 2019. Megjithatë, sfida mbetet e madhe: borxhi historik i akumuluar gjatë dy dekadave (2003-2023) arrin në rreth 1.1 milionë Lekë. Deri më tani është vjelë vetëm 15% e këtij borxhi, duke kërkuar një rishikim të mekanizmave të vjeljes për të parandaluar rritjen e mëtejshme të debisë.*

### 4.3 SISTEMI PËR MENAXHIMIN E RISKUT

137. Sistemi aktual i menaxhimit të riskut në Drejtorinë e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave është në një fazë fillestare dhe nuk është i formalizuar plotësisht. Drejtoria ka krijuar një regjistër risku për vitin 2025, Nr. 106 Prot., datë 09.01.2025, ku janë evidentuar 10 risqe dhe mbështetet gjithashtu në strategjinë e riskut të Bashkisë Kolonjë, por nuk ekziston një dokument operacional i detajuar për menaxhimin e tyre.
138. Proceset e identifikimit të riskut fokusohen kryesisht te objektivat fiskale dhe përfshijnë risqet financiare, operative, ligjore dhe të informacionit, por dokumentimi i tyre nuk është i plotë dhe i qartë, gjë që e vështirëson monitorimin dhe menaxhimin efektiv. Risqet janë vlerësuar sipas probabilitetit dhe ndikimit, por nuk përdoret matrica standarde për prioritizimin e veprimeve dhe vetëm niveli i riskut është dokumentuar.
139. Masat për minimizimin e riskut nuk janë të detajuara dhe përqendrohen kryesisht në veprime të përgjithshme për adresimin e boshllëqeve pa procedura standarde. Monitorimi dhe raportimi i efektivitetit të masave të ndërmarra nuk kryhet në mënyrë periodike, nuk ka përditësim të masave sipas ndryshimeve të riskut dhe nuk ka raportim të rregullt drejt menaxhimentit të lartë edhe pse disa risqe konsiderohen në vendimmarrjet strategjike.
140. Roli dhe përgjegjësitë për menaxhimin e riskut nuk janë të ndara qartë brenda strukturës, gjë që mund të shkaktojë mungesë përgjegjësie dhe vonesa në trajtimin e tyre. Sistemi aktual nuk siguron një dokumentacion të integruar për identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe monitorimin e riskut dhe nuk lidhet në mënyrë të qartë me vendimmarrjen operative dhe strategjike të njësisë. Në këtë mënyrë, sistemi nuk ofron mbulim të plotë të risqeve, nuk lejon monitorim të vazhdueshëm dhe nuk integron menaxhimin e riskut në vendimmarrje. Përmirësimi i tij kërkon formalizim të procedurave, ndarje të qartë të përgjegjësiave, krijimin e mekanizmave për monitorim dhe raportim të vazhdueshëm, si dhe përdorimin e matrica standarde për analizimin dhe prioritizimin e riskut.
141. **Titulli i Gjetjes:** Mangësi në formalizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut

Nr. i Gjetjes 17	
<b>Subjekti i Audituar</b>	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave
<b>Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave</li> </ul>
<b>Përmbledhja e</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar);</li> </ul>

bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin</li> </ul>
Përshkrimi i gjetjes	<p><b>Situata:</b> Gjatë auditimit u verifikua se drejtoria ka një regjistër risku për vitin 2025, ku janë evidentuar 10 risqe, por nuk ekziston një dokument i formalizuar që përcakton masat për menaxhimin dhe minimizimin e këtyre riskut. Roli dhe përgjegjësitë për menaxhimin e riskut nuk janë ndarë qartë brenda strukturës. Proceset e identifikimit të risqeve pasqyrojnë kryesisht risqet e lidhura me objektivat e realizimit të pajetës fiskale sipas zërave përkatëse. Identifikohen risqe financiare, operative, ligjore dhe të informacionit, por dokumentimi i risqeve të identifikuar nuk është i plotë dhe i qartë. Risket janë vlerësuar sipas probabilitetit dhe ndikimit, por nuk është përdorur matrica e riskut; vetëm niveli i riskut është dokumentuar. Nuk janë vendosur masa të detajuara për të zvogëluar ose menaxhuar riskun, por vetëm veprime të përgjithshme për adresimin e boshllëqeve. Nuk ka monitorim të efektivitetit të masave, nuk ka përditësim të masave sipas ndryshimeve të riskut dhe nuk ka raportim periodik drejt menaxhmentit të lartë. Megjithatë, disa risqe janë konsideruar në vendimmarrjet strategjike të njësisë së audituar.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (<i>i ndryshuar</i>); Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Mungesa e formalizimit dhe monitorimit të sistemit të menaxhimit të riskut rrit mundësinë për mosadresim të risqeve të larta, kufizon transparencën dhe efektivitetin e vendimmarrjes dhe mund të rezultojë në humbje të të ardhurave ose efikasitet të reduktuar të administrimit fiskal.</p> <p><b>Shkaku:</b> Dobësitë lidhen me mungesën e dokumentacionit formal për menaxhimin e riskut, joqartësinë e roleve dhe përgjegjësive, dhe moszbatimin e procedurave të monitorimit dhe raportimit.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I lartë.
Konkluzioni	Drejtoria nuk ka krijuar një sistem të formalizuar dhe realisht funksional për menaxhimin e riskut, i cili përfshin identifikimin, vlerësimin, dokumentimin, masat korrigjuese, monitorimin dhe raportimin e riskut. Kjo përbën një dobësi në menaxhimin e risqeve dhe rrit mundësinë e gabimeve.
Rekomandimi	Të formalizohen procedurat e menaxhimit të riskut, të ndahen qartë përgjegjësitë, të përditësohet regjistri i riskut me matrica standarde, të hartohen plane masash dhe të kryhet monitorim periodik i riskut.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vijimësi.

<b>Statusi i rekomandimit</b>	
-------------------------------	--

**Opinion i përgjithshëm:**

2.	Të përcaktohen qartë dhe të dokumentohen detyrat për secilin funksion dhe të shmanget mbivendosja e roleve.	I mesëm.
3.	Të përditësohet baza ligjore e Drejtorisë në përputhje me legjislacionin aktual.	I mesëm.
4.	Të hartohen dhe miratohen rregulloret dhe manualët e nevojshme të punës.	I lartë.
5.	Të sigurohet dokumentim i plotë dhe raportim i rregullt i veprimtarisë.	I mesëm.
6.	Të ndërmerren masa për përdorimin e sistemeve elektronike të regjistrimit dhe monitorimit.	I mesëm.
7.	Të formalizohet raportimi periodik i performancës dhe monitorimit.	I mesëm.
8.	Të krijohet një sistem i rregullt monitorimi dhe raportimi të masave korrigjuese.	I lartë.
9.	Të bëhet ndalimi i menjëhershëm i pagesave për këto subjekte deri në shlyerjen e plotë të debisë ose nënshkrimin e një marrëveshjeje shlyerjeje me këste.	I lartë.
10.	Të hartohen njoftimet për ekzekutim të detyrueshëm dhe të njoftohen bankat e nivelit të dytë për bllokimin e llogarive të këtyre subjekteve.	I lartë.
11.	Të bëhet automatizimi i sistemit të njoftimit përmes SMS/E-mail për të gjithë subjektet që nuk paguajnë këstin e dytë brenda 15 ditëve nga afati zyrtar.	I mesëm.
12.	Të ngrihet një grup pune për verifikimin në terren të të gjithë debitorëve mbi 2-vjeçarë dhe të bëhet fshirja e debisë sipas procedurave ligjore për bizneset që vërtetohen të mbyllura.	I mesëm.
13.	Të merren masa për vjeljen dhe arkëtimin e plotë të detyrimeve në këtë sektor.	I mesëm.
14.	Të nisnin procedurat e njoftim-pagesës dhe ekzekutimit për 10 debitorët kryesorë.	I lartë.
15.	Të krijohet një regjistër elektronik me fusha të parazgjedhura për statusin social dhe të mos përdoret lista e vitit paraardhës për arkëtimet e vitit korrent.	I mesëm.
16.	Të kryhet një inventarizim fizik në terren, me prioritet blloqet problematike, të bëhet rakordimi i listës së pastrimit me listën e taksës së ndërtesës si dhe të kryhet përditësimi i sipërfaqeve të banimit në sistem.	I lartë.
17.	Të formalizohen procedurat e menaxhimit të riskut, të ndahen qartë përgjegjësitë, të përditësohet regjistri i riskut me matrica	I lartë.

	standarde, të hartohen plane masash dhe të kryhet monitorim periodik i riskut.	
18.	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave duhet të ndërmarrë masa për krijimin dhe funksionalizimin e një sistemi të integruar elektronik për mbajtjen e evidencave të të ardhurave, debitorëve dhe faturimeve, duke formalizuar procedurat për përditësimin, monitorimin dhe kontrollin e të dhënave, me qëllim përmirësimin e saktësisë, transparencës dhe efektivitetit të administrimit të të ardhurave vendore.	I mesëm.
19.	Të merren masat që, në procesin e dhënies dhe rinovimit të lejeve të transportit, të verifikohet fillimisht dokumentacionit ligjor i kërkuar dhe përmbushja e kriterëve legjore dhe më pas të vijohet me dhënien e licencës.	I lartë.
20.	Të nisnin procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm për debitorët e mëdhenj, të rregullohet statusi kontraktual i subjekteve që operojnë pa kontratë, të aplikohet automatikisht kamatëvonesa për çdo vonesë sipas ligjit dhe të hartohet një plan veprimi specifik për vjeljen e debisë nga jo-rezidentët.	I lartë.
21.	Të bëhet inventarizimi i të gjitha subjekteve pa kontratë dhe të pezullohet aktiviteti i tyre deri në nënshkrimin e dokumentacionit ligjor.	I mesëm.
22.	Të krijohet një grup pune specifik për ndjekjen e detyrimeve të 10 debitorëve më të mëdhenj dhe të kërkohet shlyerja e detyrimit.	I lartë.
23.	Të bëhet analizë performance për çdo inspektor terreni në këto zona dhe të vendosen objektiva mujore me pasojë masa disiplinore në raste mospërmbushje.	I lartë.
24.	Të bëhet përputhja e database-it të taksave me regjistrin e QKB-së dhe Gjendjes Civile për të plotësuar të dhënat që mungojnë.	I mesëm.
25.	Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave të krijojë sistemin e kadastrës fiskale.	I lartë.

#### Grupi i Auditimit

Laura Skënderas

Arnold Fetallari

## OBSERVACIONET

Subjekti i audituar, me shkresën Nr. 891 Prot., datë 05.02.2026 ka paraqitur Observacionet mbi gjetjet e konstatuara dhe të pasqyruara në Projekt-Raport. Observacionet janë pranuar nga ana e Njësisë së Auditit të Brendshëm me konkluzionet e paraqitura në këtë Aneks. Nga ana e njësisë së audituar nuk u kërkua takim ballafaques me Titullarin e Institucionit.

Observacioni i Gjetjes Nr. 01	<p>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave sqaron se mospërputhja e konstatuar midis strukturës organizative të miratuar dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë ka ardhur si pasojë e ndryshimeve të njëpasnjëshme organizative dhe funksionale, të cilat nuk janë reflektuar në kohë në dokumentacionin rregullator përkatës. Aktualisht, struktura funksionale e Drejtorisë ushtron veprimtarinë në përputhje me nevojat operative dhe ngarkesën reale të punës, duke garantuar vazhdimësinë e shërbimit dhe përmbushjen e objektivave për mbledhjen e të ardhurave.</p> <p>Drejtoria vlerëson rekomandimin e auditit dhe angazhohet që, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për harmonizimin e plotë të strukturës organizative me Rregulloren e Brendshme, brenda afatit të përcaktuar.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Audituesit vlerësojnë angazhimin e Drejtorisë për harmonizimin e strukturës me Rregulloren. Megjithatë, mospërputhja aktuale cenon parimin e ligjshmërisë organizative. Deri në miratimin e akteve të reja rregullatore, gjetja mbetet e hapur.</p>
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 02	<p>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave bën me dije se ndarja e detyrave operative aktualisht realizohet në bazë të praktikës së brendshme të punës dhe nevojave të shërbimit, duke siguruar mbulimin e funksioneve kryesore në terren dhe në administrim.</p>
-------------------------------	--

	<p>Megjithatë, pranohet se kjo ndarje nuk është e formalizuar plotësisht në dokumentacionin rregullator, çka mund të krijojë paqartësi në përcaktimin e përgjegjësive individuale. Në këtë kuadër, Drejtoria angazhohet që të hartojë dhe formalizojë përshkrimet e detajuara të detyrave për çdo funksion operativ, duke përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, në përputhje me strukturën organizative dhe rregulloren në fuqi. Aktualisht ne e kemi hequr nga rregullore e brendshme termin Faturues Tregu dhe detyren dhe funksionin e kesaj kryejne Inspektoret e terenit ,mbarvajne kontrollin ,presin faturet ose biletat .dhe menaxhojne tregun</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Pranohet sqarimi mbi ndarjen operative, por formalizimi i detyrave është kusht për llogaridhënien. Heqja e termit "Faturues Tregu" pa një përshkrim të ri pune për inspektorët krijon vakum procedural. Gjetja mbetet deri në dokumentimin e plotë.</p>
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 03	<p>Drejtoria e të Ardhurave dhe Tatim-Taksave sqaron se veprimtaria e saj mbështetet në legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore, financat vendore dhe administrimin e taksave dhe tarifave lokale.</p> <p>Mungesa e pasqyrimin të plotë të bazës ligjore në Rregulloren e Brendshme përbën një mangësi formale, e cila nuk ka ndikuar në ushtrimin praktik të funksioneve të Drejtorisë, por që kërkon korrigjim për rritjen e qartësisë institucionale dhe transparencës.</p> <p>Drejtoria vlerëson rekomandimin dhe angazhohet që të propozojë përditësimin e Rregullores së Brendshme, duke reflektuar bazën ligjore përkatëse, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	<p>Edhe pse cilësohet si mangësi formale nga subjekti, mungesa e bazës ligjore në rregullore rrit riskun e veprimeve administrative të kontestueshme. Konkludohet se rregullorja</p>

	duhet të përditësohet urgjentisht.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 04	<p>Ne vijimin të gjetjes tuaj lidhur me mungesën e formalizimit të mjedisit të kontrollit të brendshëm dhe manualeve të punës, sqarojmë sa vijon :</p> <p>Drejtoria ka funksionuar duke mbështetur kryesisht legjislacionin në fuqi, aktet nenligjore, urdhrat dhe udhëzimet e eporeve, si dhe praktikën e konsoliduar të punës. Megjithatë, konstatojmë se këto procedura nuk janë formalizuar në rregullore dhe manuale të shkruara, çka përben mangësi në aspektin e dokumentimit të mjedisit të kontrollit të brendshëm . Kjo situatë ka ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë në punë , mungesë burimesh të specializuara si dhe ndryshime të shpeshta ligjore që kërkojnë përditësim të vazhdueshëm të procedurave të brendshme. Në zbatim të rekomandimeve tuaja , Drejtoria angazhohet që :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të hartojë dhe të miratojë rregullore të brendshme të punës sipas udhëzimeve përkatëse</li> <li>• Të përgatis manual procedurial për proceset kryesore të punës :</li> <li>• Të formalizojë qartë rolet, përgjegjësit dhe linjat e raportimit:</li> <li>• Të forcojë mjedisin e kontrollit të brendshëm në përputhje me standartet dhe praktikën me të mira :</li> </ul> <p>Keto masa do ndërmeren Brenda afatëve të përcaktuara , me qëllim rritjen e transparencës, efikasitetit dhe forcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Audituesit konstatojnë se mbështetja vetëm në praktikën e konsoliduar pa manuale të shkruara rrit riskun e gabimit dhe subjektivizmit. Angazhimi për hartimin e manualeve vlerësohet, por niveli i lartë i riskut dikton monitorim të plotë.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacioni i Gjetjes Nr. 05	Ne vijimin te gjetjes tuaj lidhur mungese e dokumentacionit te plot dhe te qendrueshem per planifikimin dhe raportimin e veprimtarise. Struktura pranon gjetjen e konstatuar nga auditi.Mungesa ne dokumentacion kane ardhur si pasoje e ngarkeses se shtuar te punes ,ndryshimeve te shpeshta organizative ,si dhe mungese ten je formati te unifikuar per planifikim dhe raportimin e veprimtaris .Ne vijim,Drejtoria do te mare masa per hartimin dhe standartizimin e dokumentacionit per planifikimin vjetor dhe raportimin periodic te veprimtarise ,duke garantuar ruajtjen perditesimin dhe arkivimin e tij ne menyre te qendrueshme ,me qellim permiresimin e procesit te monitorimit dhe rritjen e transparences insitcionale.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Pranimi i gjetjes dhe identifikimi i mungesës së formateve të unifikuara vërteton mangësitë në monitorim. Nevojitet implementimi i menjëhershëm i sistemeve të raportimit për të siguruar gjurmueshmërinë e veprimtarisë.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 06	Ne vijimin te gjetjes tuaj perdorimi i sistemeve manuale per regjistrimin dhe monitroimin e te ardhurave dhe debitoreve . Struktura pranon pjeserisht gjetjen e auditit.Perdorimi i sistemeve manual ka qene i diktuar nga nugesia e mosfunktionimit I plot ten je sisitemi elktronik te integruar ,si dhe pasoje nga nevoj per te garantuar vazhdimesin e punes dhe ruajtjen e te dhenave .Megjithate Drejtoria eshte e angazhuar per te rritur perdorimin e sistemit elektronik,duke permiresuar procesin e regjistrimit dhe monitorimit te te ardhurave dhe debitoreve ,si dhe duke synuar reduktimin gradual te proseceve manual ,me qellim rritjen e saktetise se te dhenave dhe eficences ne pune .
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Audituesit theksojnë se përdorimi i sistemeve manuale është burim i lartë gabimesh

	njerëzore dhe vonesash. Angazhimi për reduktim gradual është i pamjaftueshëm; kërkohet një plan konkret për digjitalizimin e plotë.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

<p>Observacioni i Gjetjes Nr. 07</p>	<p>Ne vijimin të gjetjes tuaj dobësi në sistemin e informimit, komunikimit dhe raportimit të performancës</p> <p>Struktura përgjegjëse ka qenë e angazhuar në kryerjen e detyrave funksionale dhe operacionale, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Megjithatë, pranohet se sistemi i informimit dhe komunikimit të brendshëm, si dhe raportimi i performancës, nuk ka qenë i formalizuar dhe i standardizuar në të gjitha hallkat organizative, çka ka sjellë mangësi në dokumentimin dhe konsolidimin e të dhënave periodike të performancës.</p> <p>Dobësitë e konstatuara lidhen kryesisht me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mungesën e procedurave të shkruara për rrjedhën e informacionit dhe komunikimin ndërstrukturor;</li> <li>• raportim jo të njëtrajtshëm të indikatorëve të performancës;</li> <li>• mungesë të një formati standard për raportet periodike të performancës.</li> </ul> <p>Theksojmë se informacioni dhe komunikimi janë realizuar në praktikë, por jo gjithmonë të dokumentuara sipas standardeve të kërkuara, gjë që ka ndikuar në vlerësimin e plotë dhe objektiv të performancës institucionale.</p> <p>Masat e ndërmarra dhe/ose të planifikuara</p> <p>Në funksion të adresimit të kësaj gjetjeje, janë planifikuar dhe/ose kanë filluar të ndërmerren këto masa:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi dhe miratimi i procedurave të brendshme për sistemin e informimit</li> </ol>
--------------------------------------	--

	<p>dhe komunikimit institucional.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Përcaktimi i formateve standarde për raportimin periodik të performancës.</li> <li>3. Rritja e kordinimit ndërmjet strukturave përmes takimeve periodike dhe shkëmbimit të dokumentuar të informacionit.</li> <li>4. Përmirësimi i arkivimit dhe dokumentimit të raporteve të performancës për qëllime monitorimi dhe vlerësimi.</li> </ol> <p>Në përfundim, struktura angazhohet që brenda afateve të përcaktuara të përmirësojë sistemin e informimit, komunikimit dhe raportimit të performancës, duke garantuar transparencë, gjurmueshmëri dhe përputhje me kërkesat e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Mungesa e dokumentimit të komunikimit ndërstrukturor vështirëson auditimin e performancës. Konkludohet se deri në miratimin e formateve standarde të raportimit, sistemi mbetet i pambrojtur nga moskoordinimi.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 08	<p>Ne vijimin të gjetjes tuaj, Mangësi në monitorimin e efektivitetit të masave dhe ndjekjen e veprimeve korigjuese.</p> <p>Në lidhje me gjetjen e konstatuar nga Audit, bëjmë me dije se institucioni e vlerëson këtë gjetje si të drejtë dhe e pranon nevojën për përmirësim të mëtejshëm të procesit të monitorimit të efektivitetit të masave të marra, si dhe të ndjekjes sistematike të veprimeve korigjuese.</p> <p>Mangësitë e konstatuara lidhen kryesisht me mungesën e një mekanizmi të formalizuar monitorimi, i cili të sigurojë vlerësimin periodik të zbatimit dhe efektivitetit të masave korigjuese, si dhe dokumentimin e rezultateve të tyre. Aktualisht, ndjekja e këtyre masave</p>
-------------------------------	--

	<p>është realizuar në mënyrë jo të plotë dhe pa një raportim të strukturuar.</p> <p>Në këtë kuadër, institucioni angazhohet që në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të hartojë dhe miratojë procedura të brendshme për monitorimin e efektivitetit të masave dhe ndjekjen e veprimeve korrigjuese;</li> <li>• Të përcaktojë përgjegjësi të qarta për njësitë dhe personat përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e masave;</li> <li>• Të realizojë monitorim periodik dhe raportim të dokumentuar mbi progresin dhe rezultatet e masave të marra;</li> <li>• Të përmirësojë sistemin e kontrollit të brendshëm me qëllim parandalimin e përsëritjes së problematikave të ngjashme në të ardhmen.</li> </ul> <p>Zbatimi i këtyre masave do të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të kontrollit të brendshëm dhe në përmirësimin e performancës institucionale në përputhje me rekomandimet e Auditit.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Pranimi i gjetjes konfirmon se drejtoria nuk ka pasur një mekanizëm për ndjekjen e masave korrigjuese. Pa një procedurë të formalizuar monitorimi, efektiviteti i kontrollit të brendshëm mbetet i ulët.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

**Observacion mbi Sistemin për Tarifat dhe Taksat e Biznesit**

Observacioni i Gjetjes Nr. 09	<p>Ne vijimin të gjetjes tuaj mungese e arketimit të detyrimeve nga subjektet me kontrata Prokurimi</p> <p>Institucioni e pranon gjetjen e konstatuar nga auditi lidhur me mungesën e arkëtimit të detyrimeve financiare nga subjektet që kanë lidhur kontrata prokurimi, ku shkalla e vjeljes rezulton në nivelin 0%.</p> <p>Kjo situatë është krijuar si pasojë e mangësive në ndjekjen sistematike të detyrimeve</p>
-------------------------------	---

	<p>kontraktuale, mungesës së një mekanizmi të mirëkoordinuar ndërmjet strukturave përgjegjëse për prokurimin, financën dhe arkëtimin, si dhe mosaplikimit në kohë të masave penalizuese të parashikuara në kontrata.</p> <p>Në vijim, institucioni angazhohet që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të evidentojë në mënyrë të detajuar të gjitha detyrimet e papaguara nga subjektet kontraktuese;</li> <li>• të ndërmarrë veprime konkrete për njoftimin dhe ndjekjen e arkëtimin të këtyre detyrimeve;</li> <li>• të forcojë bashkëpunimin ndërmjet strukturave përgjegjëse për prokurimin, financën dhe të ardhurat;</li> <li>• të zbatojë në mënyrë rigoroze klauzolat kontraktuale dhe masat penalizuese në rast mosrespektimi të detyrimeve financiare;</li> <li>• të përmirësojë procedurat e monitorimit dhe raportimit të detyrimeve kontraktuale, me qëllim rritjen e shkallës së vjeljes në periudhat në vijim.</li> </ul> <p>Zbatimi i këtyre masave do të kontribuojë në përmirësimin e performancës financiare të institucionit dhe në forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Shkalla e vjeljes 0% për kontratat e prokurimit është një dështim i kontrollit financiar. Audituesit kërkojnë ndjekje ligjore të menjëhershme për këto detyrime dhe bashkëpunim ndërinstitucional pa vonesë.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacioni i Gjetjes Nr. 10	<p>Ne vijimin të gjetjes tuaj Mungesë e masave shtrënguese për debitorët me vonesa mbi 12 mujore sqarojmë se institucioni e vlerëson gjetjen si të drejtë dhe të bazuar.</p> <p>Mungesa e aplikimit sistematik të masave</p>
-------------------------------	--

	<p>shtrënguese ndaj debitorëve me vonesa mbi 12 mujore ka ardhur si pasojë e kapaciteteve të kufizuara administrative, mungesës së procedurave të brendshme të detajuara për ndjekjen e debitorëve afatgjatë, si dhe prioritizimit të arkëtimit vullnetar përmes njoftimeve dhe komunikimeve paraprake.</p> <p>Megjithatë, gjatë periudhës së fundit janë ndërmarrë dhe janë planifikuar masa konkrete për përmirësimin e situatës, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimi dhe përditësimi i listës së debitorëve me vonesa mbi 12 mujore;</li> <li>• Fillimi i procedurave për aplikimin e masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin në fuqi;</li> <li>• Hartimi dhe miratimi i një plani veprimi për ndjekjen sistematike të debitorëve afatgjatë;</li> <li>• Rritja e monitorimit dhe raportimit periodik mbi ecurinë e masave të marra.</li> <li>• Per biznesin Fizik dhe Juridik meren masa dergohen gjith njoftimet perkatese per ekzekutim vullnetar pasatj beht bllokim llogarise bankare keto haoa jane ndjekur</li> <li>• Per Familjaret nuk kemi nje sistem te dixhitalizuar per masa shtenguese.</li> </ul> <p>Institucioni angazhohet që në vijim masat shtrënguese të aplikohen në mënyrë të rregullt dhe të dokumentuar për të gjithë debitorët me vonesa mbi 12 mujore, me qëllim rritjen e nivelit të arkëtimit dhe forcimin e disiplinës financiare.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Diferencimi midis biznesit (ku merren masa) dhe familjarëve (ku mungon sistemi) tregon pabarazi në trajtimin e debitorëve. Nevojitet urgjentisht një zgjidhje teknike edhe për kategorinë e familjarëve.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacioni i Gjetjes Nr. 11	Ne vijimin te gjetjes tuaj ,mos permbushja e
-------------------------------	--

	<p>objektivave te arketimit gjate pjese se dyte te vitit ,duke ju referuar gjetjes së auditit mbi mos përmbushjen e objektivave të arkëtimit gjatë pjesës së dytë të vitit, informojmë se janë ndërmarrë masat e mëposhtme për të përmirësuar situatën dhe për të siguruar realizimin e objektivave të ardhshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Rishikimi i planeve të arkëtimit:</b> Janë rishikuar dhe përditësuar planet mujore të arkëtimit për pjesën e mbetur të vitit, duke identifikuar prioritetet dhe zërat me vonesë në arkëtim.</li> <li>2. <b>Pagesa behet me 2 keste .</b>Per biznesin fizik 20 prill dhe 20 tetor dhe shumica e bineseve e paguajne total detyrimin dhe kjo ndodh n gje gjat pjeses se dyte te vitit te kete kete ulje .</li> <li>3. <b>Inspektoret e terrenit.</b>Bejne njoftimet perkatese te kordinuar me vete Qytet me vete Njesit Administrative brenda afatave ,shperndahen njoftim .</li> </ol> <p><b>Përfundim:</b> Drejtoria ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar realizimin e objektivave të arkëtimit në pjesën e mbetur të vitit dhe për të parandaluar përsëritjen e situatave të ngjashme. Monitorimi i vazhdueshëm dhe kordinimi me të gjitha njësitë përkatëse do të sigurojë përmbushjen e objektivave të ardhshme në mënyrë efektive dhe në kohë.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Sqarimi mbi pagesën me dy këste pranohet pjesërisht, por kjo nuk justifikon mosarritjen e objektivave vjetore. Nevojitet një analizë më e thellë mbi shpërndarjen e njoftimeve nga inspektorët e terrenit.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 12	Ne vijimin te gjetjes tuaj , Mosrakordim midis statusit aktiv të subjekteve të regjistruara në sistem dhe gjendjes reale të tyre, duke rezultuar në mbajtjen aktive në sistem të subjekteve që faktikisht nuk ushtrojnë aktivitet.
-------------------------------	--

	<p>Në lidhje me gjetjen e auditit, sqarojmë se mosrakordimi i evidentuar ka ardhur kryesisht si pasojë e mungesës së informacionit të përditësuar në kohë nga subjektet, vonesave në njoftimin e ndryshimeve të statusit të tyre, si dhe nevojës për përmirësim të procedurave të verifikimit periodik të të dhënave në sistem.</p> <p>Për adresimin e kësaj problematike, janë ndërmarrë këto masa konkrete:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Verifikim dhe rakordim i të dhënave:</b> Marim te dhena vetem kur bejen kerkese ne Qkb per pezullim ose mbyllje te Niptit .</li> <li>2. <b>Informim dhe ndërgjegjësim i subjekteve:</b> Janë ndërmarrë masa për informimin e subjekteve mbi detyrimin për deklarimin në kohë të çdo ndryshimi në statusin e tyre ligjor dhe ekonomik.</li> </ol> <p><b>Përfundim:</b> Drejtoria ka marrë masat e nevojshme për korrigjimin e mospërputhjeve të konstatuara dhe për përmirësimin e kontrollit të të dhënave në sistem, me qëllim garantimin e saktësisë, transparencës dhe përputhshmërisë së informacionit në vijim.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Mbajtja aktive e subjekteve që nuk ushtrojnë aktivitet fryn artificialisht pritshmëritë për të ardhura. Audituesit insistojnë në një rakordim periodik (çdo 3 muaj) me QKB dhe jo vetëm me kërkesë të subjektit.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 13	<p>Ne vijimin te gjetjes tuaj , mos arketimi i plot i detyrimeve financiare ne sektorin Bar-restorant.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Sbjektet Bar Kafe:</b>Pagauajn pothuajse ne masen 95 % kestet sipas afatve.</li> <li>➤ <b>Bar –Restorantet :</b> Paguajne ne masen 99 % detyrimet e kesteve sipas afateve.</li> </ul>
-------------------------------	--

	<p>➤ <b>Juridiket:</b> Afatet perkatese i kane Brenda dates 20 Qershor me nje Kest jane te rregull ne masen 99%</p> <p><b>Perfundim:</b>Nuk kemi mangesi ne Subjektin Fizik apo Jurdik sa do i paket te jete numri tyre .Per llogaritjen e kamatvoneses do meren parasysh konkluzionet e lena dhe te kemi nje permiresim sa me te mire .</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Shifrat e larta të arkëtimit (95-99%) vlerësohen pozitivisht, por gjetja mbi përlllogaritjen e kamatëvonesave mbetet relevante për të siguruar arkëtimin e plotë sipas ligjit.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

#### Observacion mbi Sistemin për Tarifat dhe Taksat e Familjeve:

Observacioni i Gjetjes Nr. 14	<p>Ne vijimin te gjetjes tuaj , <b>mungese efikasiteti ne vjeljen e detyrimeve dhe administrimi i dobet i debise</b> Administrimi i debisë dhe procesi i vjeljes së detyrimeve janë ndikuar nga disa faktorë objektivë dhe subjektivë, ndër të cilët evidentohen: volumi i lartë i detyrimeve të prapambetura ndër vite, kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe teknike, si dhe mungesa e një sistemi të integruar monitorimi për ndjekjen në kohë të debitorëve.</p> <p>Gjithashtu, një pjesë e detyrimeve i përket subjekteve joaktive ose atyre me vështirësi financiare, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në uljen e eficiencës së arkëtimit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se janë ndërmarrë veprime për përmirësimin e situatës, duke përfshirë identifikimin e debitorëve me risk të lartë, rritjen e kontrolleve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial.</p> <p><b>Përfundim:</b> Njësia angazhohet të përmirësojë administrimin e debisë dhe të rrisë efikasitetin e vjeljes së detyrimeve përmes forcimit të mekanizmave të monitorimit, përditësimit të</p>
-------------------------------	--

	bazës së të dhënave të debitorëve dhe zbatimit të masave ligjore në fuqi, me qëllim uljen graduale të stokut të debisë dhe garantimin e disiplinës financiare.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Vëllimi i lartë i debisë së prapambetur kërkon masa konkrete dhe jo vetëm angazhime vullnetare. Mungesa e një sistemi të integruar mbetet shkaku kryesor i administrimit të dobët.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacioni i Gjetjes Nr. 15	<p>Ne vijimin të gjetjes tuaj pasaktësi në administrimi e bazës së të dhënave dhe mungesë standartizimit në raportim</p> <p>Në lidhje me pasaktësitë në administrimin e bazës së të dhënave dhe mungesën e standardizimit në raportim, sqarojmë se kjo situatë ka ardhur si pasojë e përdorimit të burimeve të ndryshme të të dhënave, mungesës së një sistemi unik dhe përditësimeve jo të njëkohshme nga njësitë përgjegjëse.</p> <p>Për adresimin e kësaj gjetjeje janë ndër marrë dhe planifikuar masat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Rishikimi dhe pastrimi i bazës së të dhënave:</b> Është nisur procesi i verifikimit, përditësimit dhe harmonizimit të të dhënave ekzistuese për të eliminuar pasaktësitë dhe dublimet.</li> <li>2. <b>Standardizimi i raportimit:</b> Janë hartuar dhe miratuar formate standarde raportimi, të cilat do të përdoren nga të gjitha njësitë përkatëse për të siguruar një paraqitje të unifikuar dhe të saktë të informacionit.</li> <li>3. <b>Përmirësimi i procedurave të brendshme:</b> Janë rishikuar procedurat ekzistuese për administrimin e të dhënave dhe raportimin, me qëllim rritjen e saktësisë dhe transparencës.</li> <li>4. <b>Trajnimi i stafit:</b> Për vitin 2026 kemi</li> </ol>
-------------------------------	---

	<p>kerkuar trajnime me tema ate ndryshme per organizimin sa me te sakte te menaxhimit dhe administrimit te baze se te dhenave .</p> <p><b>Përfundim:</b> Zbatimi i masave të mësipërme do të sigurojë administrim më të saktë të bazës së të dhënave dhe raportim të standardizuar, duke parandaluar përsëritjen e problematikave të evidentuara nga auditi.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Pasaktësitë në bazën e të dhënave cenojnë vendimmarrjen. Trajnimi i planifikuar për vitin 2026 është hap pozitiv, por pastrimi i të dhënave duhet të kryhet në mënyrë prioritare brenda këtij viti fiskal.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

Observacioni i Gjetjes Nr. 16	<p>Ne vijimin te gjetjes tuaj ,disproporcioni i arketimit sipas zonave (Blloqeve)dhe mbulim i pjesshem i Taksës se Pasurisë</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Analiza e arkëtimit sipas zonave:</b> Është kryer analizë krahasuese e nivelit të arkëtimit për çdo zonë (bllok), me qëllim identifikimin e zonave me risk të lartë dhe nivel të ulët mbulimi ,i kemi te ndara te 6 Blloqet e Qytetit Ereke.</li> <li>2. <b>Përditësimi i bazës së të dhënave të pasurive:</b> Po vijon procesi i verifikimit dhe pasurimit të të dhënave për subjektet dhe pasuritë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse, për të rritur mbulimin e Taksës së Pasurisë.</li> <li>3. <b>Intensifikimi i masave të arkëtimit:</b> Janë planifikuar veprime të fokusuara në zonat me performancë të ulët arkëtimi, përmes njoftimeve, komunikimit me subjektet dhe ndjekjes administrative sipas legjislacionit në fuqi.</li> <li>4. <b>Përmirësimi i monitorimit:</b> Është forcuar monitorimi periodik i arkëtimeve sipas zonave, duke</li> </ol>
-------------------------------	--

	<p>vendosur tregues performance për çdo bllok.</p> <p>5. <b>Koordinimi ndërinstitucional:</b> Përritet bashkëpunimi me institucionet përkatëse për shkëmbimin e informacionit mbi pasuritë dhe statusin e tyre ligjor.</p> <p><b>Përfundim:</b> Zbatimi i masave të mësipërme synon reduktimin e disproporcioneve të arkëtimit ndërmjet zonave dhe rritjen graduale të mbulimit të Taksës së Pasurisë, duke përmirësuar eficiencën e administrimit të të ardhurave vendore dhe duke parandaluar përsëritjen e problematikave të evidentuara nga auditet.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Disproporcioni sipas zonave tregon për një menaxhim jo të njëtrajtshëm të burimeve njerëzore (inspektorëve). Nevojitet rishpërndarje e ngarkesës së punës bazuar në potencialin e arkëtimit të çdo blloku.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

#### Observacion mbi Sistemin për Menaxhimin e Riskut:

Observacioni i Gjetjes Nr. 17	<p>Ne vijme te gjetjes tuaj ,mungesë në formalizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut.</p> <p>Në lidhje me gjetjen e auditit mbi mangësitë në formalizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të riskut, sqarojmë se struktura ka zbatuar elementë të menaxhimit të riskut në praktikë, por pa një dokumentim dhe formalizim të plotë sipas standardeve të kërkuara.</p> <p>Për adresimin e kësaj gjetjeje janë ndërmarrë dhe planifikuar masat e mëposhtme:</p> <p>1. <b>Formalizimi i kuadrit të menaxhimit të riskut:</b> Është iniciuar procesi për hartimin dhe miratimin e dokumentacionit përkatës (politika,</p>
-------------------------------	--

	<p>procedura dhe matrica e riskut), në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e kontrollit të brendshëm.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. <b>Identifikimi dhe vlerësimi i riskut:</b> Janë identifikuar risqet kryesore që lidhen me aktivitetin e njësisë dhe po kryhet vlerësimi i tyre sipas probabilitetit dhe ndikimit.</li> <li>3. <b>Vendosja e masave kontrolluese:</b> Për çdo risk të identifikuar po përcaktohen masa konkrete për reduktimin ose menaxhimin e tij, si dhe përgjegjësit për zbatimin e këtyre masave.</li> <li>4. <b>Monitorimi dhe raportimi periodik:</b> Është planifikuar monitorimi periodik i riskut dhe raportimi i tij tek drejtuesit përkatës, me qëllim përmirësimin e vendimmarrjes.</li> <li>5. <b>Trajnimi i stafit:</b> Staf i përkatës do të trajnohet mbi parimet e menaxhimit të riskut dhe rolin e tij në funksionimin efektiv të sistemit.</li> </ol> <p><b>Përfundim:</b> Zbatimi i masave të mësipërme do të mundësojë krijimin dhe funksionimin e një sistemi të formalizuar dhe efektiv të menaxhimit të riskut, duke përmirësuar kontrollin e brendshëm dhe duke parandaluar përsëritjen e problematikave të evidentuara nga auditi.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Menaxhimi i riskut në praktikë pa dokumentim, nuk është i matshëm. Audituesit konkludojnë se pa një Matricë Risku të miratuar nga Titullari, institucioni mbetet i ekspozuar ndaj kërcënimeve operationale.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacion mbi Sistemin për Mbajtjen e Listave

Observacioni i Gjetjes Nr. 18	Ne vijme te gjetjes tuaj , mungesa e një sistemi të unifikuar dhe të automatizuar për menaxhimin e listave, evidencave të të ardhurave, debitorëve dhe faturimeve. Në lidhje me gjetjen e auditit mbi mungesën e
-------------------------------	--

	<p>një sistemi të unifikuar dhe të automatizuar për administrimin e listave, evidencave të të ardhurave, debitorëve dhe faturimeve, sqarojmë se aktualisht proceset përkatëse realizohen manualisht dhe evidencave të ndara, Familjaret, Subjektet Fizik ,Juridik ,Toka buqesore. Trualli, Tokat me Qera, Hapsirat publike, Hecetetj te gjitha jane te ndare me tabela perkatese.</p> <p>Për adresimin e kësaj problematike janë ndërmarrë dhe planifikuar masat e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Vlerësimi i nevojave dhe proceseve ekzistuese:</b> Është kryer analizë e proceseve aktuale të administrimit të të ardhurave, debitorëve dhe faturimeve, me qëllim identifikimin e mangësive dhe pikave që kërkojnë automatizim.</li> <li>2. <b>Planifikimi i një sistemi të integruar:</b> Është planifikuar krijimi ose adoptimi i një sistemi të unifikuar informatik, i cili do të mundësojë menaxhimin e centralizuar të listave, të ardhurave, debitorëve dhe procesit të faturimit.</li> <li>3. <b>Standardizimi i të dhënave:</b> Po punohet për standardizimin e formateve dhe strukturës së të dhënave, me qëllim integrimin e tyre në një platformë të vetme.</li> <li>4. <b>Rritja e kontrollit dhe transparencës:</b> Sistemi i planifikuar do të lehtësojë monitorimin në kohë reale të të ardhurave, gjendjes së debitorëve dhe procesit të faturimit, duke rritur kontrollin e brendshëm dhe transparencën.</li> <li>5. <b>Trajnimi i stafit dhe zbatimi gradual:</b> Parashikohet trajnimi i stafit dhe implementimi gradual i sistemit, për të garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe minimizim të riskut operacional.</li> </ol> <p><b>Përfundim:</b> Zbatimi i masave të mësipërme do të kontribuojë në krijimin e një sistemi të</p>
--	--

	unifikuar dhe të automatizuar për administrimin e të ardhurave, debitorëve dhe faturimeve, duke rritur eficiencën, saktësinë e të dhënave dhe cilësinë e raportimit, si dhe duke parandaluar përsëritjen e problematikave të evidentuara nga auditit.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Ekzistenca e tabelave të ndara (manuale) vërteton mungesën e një sistemi unik. Fragmentimi i të dhënave rrit riskun e mospërputhjeve financiare midis listave të ndryshme të pasurive.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

### Observacion mbi Sistemin për Menaxhimin e dhënies së Lejeve të Transportit

Observacioni i Gjetjes Nr. 19	<p>Ne vijme te gjetjes tuaj , mangesi ne dokuemnatacion shoqerues per dhenien dhe rinovimin e lejeve te transportit.</p> <p>Në lidhje me gjetjen e auditit mbi mungesën e dokumentacionit ne vazhdimesi do meren masa sygjerruar dhe nga ana juaj qe Çertifikatat e Transportit te jene me dokumente te plotesuara .</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leje Qarkullimi</li> <li>• Siuracion</li> </ul> <p><b>Përfundim:</b> Zbatimi i masave të mësipërme do te zbatohen ne vazhdimesi.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Dokumentacioni i paplotë në dhënien e lejeve të transportit është shkelje e drejtpërdrejtë procedurale. Angazhimi për plotesim në vazhdimësi duhet të shoqërohet me një kontroll verifikues për të gjitha lejet e lëshuara së fundmi.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

### Observacion mbi Sistemin për Mbledhjen e Detyrimeve të Prapambetura

Observacioni i Gjetjes Nr. 20	Ne vijme te gjetjes tuaj, te mësipërme, sqarojmë se struktura përgjegjëse ka ushtruar
-------------------------------	---

	<p>veprimtarinë e saj në kushtet e një volumi të lartë të debive të akumuluar ndë vite, si dhe përballë kufizimeve objektive administrative dhe ligjore që kanë ndikuar në ritmin e vjeljes së detyrimeve të prapambetura.</p> <p>Pranohet se në disa raste ka pasur mungesë efikasiteti në ndjekjen sistematike të debive progresive, si dhe parregullësi në dokumentimin dhe përditësimin e të dhënave, çka ka ndikuar në mosrealizimin e nivelit të pritshëm të arkëtimeve.</p> <p>Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë situatë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vështirësitë në identifikimin dhe lokalizimin e subjekteve debitore;</li> </ul> <p>Theksojmë se, megjithatë, janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, por efektiviteti i tyre nuk ka qenë gjithmonë në nivelin e kërkuar nga standardet e kontrollit të brendshëm dhe praktikat më të mira financiare.</p> <p><b>Masat e ndërmarra ose të planifikuara</b></p> <p>Për përmirësimin e situatës dhe adresimin e gjetjes së auditimit, janë planifikuar/ndërmarrë këto masa konkrete:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hartimi i një plani të posaçëm veprimi për menaxhimin dhe vjeljen e debive progresive.</li> <li>2. Klasifikimi i debive sipas vjetërsisë, shumës dhe mundësisë reale të arkëtimit.</li> <li>3. Forcimi i masave shtrënguese administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.</li> <li>4. Përmirësimi i sistemit të evidencës dhe raportimit të debive të prapambetura.</li> <li>5. Rritja e kordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për ndjekjen e</li> </ol>
--	--

	<p>detyrimeve debitore.</p> <p><b>Përfundim:</b> struktura angazhohet të përmirësojë ndjeshëm eficiencën e vjeljes së detyrimeve të prapambetura, duke reduktuar nivelin e debisë progresive dhe duke garantuar një menaxhim më efektiv dhe transparent të të ardhurave.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Vështirësitë në lokalizimin e debitorëve tregojnë nevojën për bashkëpunim me zyrën e gjendjes civile dhe kadastrën. Plani i posaçëm i veprimit duhet të ketë afate konkrete dhe objektiva mujore vjeljeje.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacioni i Gjetjes Nr. 21	<p>Ne vijim të gjetjes tuaj ,per subjektet pa kontarte të rregullt ,shembull Caushi Sh.p.k Subjekti nuk është paisur me Kontrate pasi është në proces gjyqësor dhe deri në përfundim të gjyqit të jepet vendimi final nuk vjelim dot debine .</p> <p>Subjekti lartë përmendur ka kontrate të re qeraje me Bashkinë Kolonje date 02.09.2024 me Nipt K98217001T dhe rezulton taksapagues i rregullt.</p> <p><b>Përfundim:</b> struktura angazhohet të përmirësojë ndjeshëm për një arketim sa më korrekt për të Ardhurat e Bashkisë Kolonje që ndikojnë në të mirë të komunitetit.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Audituesit konstatojnë se ekzistenca e një procesi gjyqësor nuk duhet të pengojë dokumentimin e plotë të debisë progresive. Vlerësohet fakti që subjekti ka lidhur kontratë të re në vitin 2024, por për periudhat e mëparshme pa kontratë, institucioni duhet të kishte aplikuar masa mbrojtëse financiare. Gjetja qëndron deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të detyrimeve të prapambetura.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

<p>Observacioni i Gjetjes Nr. 22</p>	<p>Ne vijim te gjetjes tuaj ,per debitorët e mbedhenj shembull El Paver ka lidhur Akt-Marveshje me Bashkine Kolonje dhe e zbaton sipas ligjeve ne fuqi per vitin 2025 ka paguar sipas rregullit 20% te total debise dhe kesti e pare te lidhur ne Akt –Marveshje.</p> <p>Golden Nutes ka mare cdo njoftim zyrtar deri ne mas shtenguese problem eshte adresari dhe pergjigje kthehn mbrapsht ,jane mare masa dhe hapa me Drejtorin Juridke per process gjyqesor.</p> <p><b>Përfundim:</b> struktura angazhohet të përmirësojë ndjeshem per vjeljen e debise te ketyre subjekteve pasi zene peshen kryesore te te ardhurave ne Bashkine Kolonje.</p>
<p>Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen</p>	<p>Për rastin "El Power", vlerësohet ndjekja përmes Akt-Marrëveshjes, por audituesit theksojnë se shlyerja prej 20% është në nivel minimal për debitorë të mëdhenj. Për rastin "Golden Nuts", mungesa e adresarit tregon dobësi në administrimin e dosjeve të subjekteve. Deri në arkëtimin efektiv të kësteve dhe fillimin e procesit gjyqësor për debitorin e dytë, risku mbetet i lartë.</p>
<p>Rishikim i statusit të gjetjes</p>	<p>Gjetja qëndron.</p>
<p>Rishikim i nivelit të riskut</p>	<p>I lartë.</p>

<p>Observacioni i Gjetjes Nr. 23</p>	<p>Ne vijim te gjetjes tuaj ,Fshatrat e thelle si Radivicka,Orgocka,Qinam Radovicke,Kozel-Pepellash ,Bezhan etj.jane fshatra te braketisura nuk kane asnje banore por ne baze te gjendjes civile u taksohet vetem toka buqesore qe eshte ndare me ligjin 7501 dhe ne regjistrin e taksave kalon automatikisht cdo vit.</p> <p><b>Përfundim:</b> struktura angazhohet te meren masa ne bashkepunim si do veprohet per Fshatrat qe nuk kane asnje banore dhe taksa u vazhdon.</p>
<p>Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen</p>	<p>Audituesit vlerësojnë sinqeritetin e subjektit mbi problematikën e fshatrave të braktisur. Megjithatë, mbajtja e tarifave aktive mbi një</p>

	bazë të dhënash që nuk reflekton realitetin (fshatra pa banorë) çon në mbifaturim dhe debi të pavjelshme (stok fiktiv). Nevojitet një vendimmarrje e Këshillit Bashkiak për trajtimin e këtyre rasteve specifike.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

Observacioni i Gjetjes Nr. 24	<p>Ne vijim te gjetjes tuaj, në lidhje me gjetjen e konstatuar nga auditimi për paskatësi në mbajtjen e regjistrave, sqarojmë se struktura përgjegjëse ka mbajtur regjistrat përkatës në përputhje me kërkesat ligjore bazë, megjithatë pranohet se në disa raste janë evidentuar mangësi në mënyrën e plotësimit, përditësimit dhe administrimit të tyre.</p> <p>Këto paskatësi kanë ardhur kryesisht si rezultat i:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mungesës së formateve të standardizuara për mbajtjen e regjistrave;</li> </ul> <p>Theksojmë se paskatësitë e konstatuara kanë karakter administrativ dhe nuk kanë sjellë tjetërsim apo humbje të dokumentacionit, por kanë ndikuar në saktësinë, gjurmueshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit të regjistruar.</p> <p>Në përfundim, struktura angazhohet të eliminojë paskatësitë e evidentuara dhe të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e mbajtjes së regjistrave, duke garantuar saktësi, transparencë dhe përputhje me kërkesat e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.</p>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Pranohet se mangësitë janë të natyrës administrative, por mungesa e formateve të standardizuara cenon parimin e "gjurmueshmërisë" së auditit. Pa regjistra të saktë dhe të unifikuar, kontrolli i brendshëm nuk mund të garantojë besueshmërinë e raporteve financiare. Gjetja konsiderohet e

	mbyllur vetëm pas miratimit të formateve të reja.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I mesëm.

#### Observacion mbi Sistemin e Kadastrës Fiskale:

Observacioni i Gjetjes Nr. 25	Ne vijim te gjetjes tuaj ,në lidhje me gjetjen e konstatuar nga auditimi për mungesëne një sistemi të kadastrës fiskale kostatohet mungesa e një sistemi të plot dhe funksional të kadastrës fiskale në administrimin e të ardhurave. Në përfundim, struktura angazhohet që të meren masat e duhura dhe fillimin e punës me sistemin e kadastrës fiskale.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen	Mungesa e një Kadastre Fiskale funksionale është një mangësi kritike që pengon vlerësimin e saktë të taksës mbi pasurinë. Audituesit nënvizojnë se pa këtë sistem, Bashkia humbet një pjesë të konsiderueshme të bazës tatimore. Angazhimi për fillimin e punës është hapi i parë, por deri në funksionalizimin e plotë, risku mbetet në nivel maksimal.
Rishikim i statusit të gjetjes	Gjetja qëndron.
Rishikim i nivelit të riskut	I lartë.

#### Grupi i Auditimit

Laura Skënderas

Arnold Fetallari